

982
26.03.26

Nr. 3260 Prot.

Tiranë, më 26.03.2026

Drejtuar:

Z. Petrit AHMETI

Kryetar i Bordit

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË (ERE)

Adresa: Rruga "Irfan Tomini", Njësia Administrative Nr. 7, Tiranë

Lënda: Dërgimi i Raportit Vjetor të Pajtueshmërisë së OSSH sh.a. për vitin 2025

I nderuar z. Ahmeti,

Në mbështetje të nenit 72 të Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, si dhe në zbatim të Programit të Pajtueshmërisë së OSSH sh.a., miratuar nga ERE me Vendimin nr. 257, datë 21.12.2020, bashkëlidhur po ju përcjellim **Raportin Vjetor të Pajtueshmërisë për vitin 2025 të OSSH sh.a.**

Raporti paraqet vlerësimin mbi zbatimin e Programit të Pajtueshmërisë dhe respektimin e detyrimeve ligjore e rregullatore, në funksion të garantimit të ndarjes funksionale, trajtimit jodiskriminues dhe mbrojtjes së informacionit konfidencial.

Ky raport paraqitet pranë ERE brenda afatit ligjor.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetem në dispozicion për çdo sqarim.

Me respekt,

ZYRTARI I PAJTUESHMËRISË

OSSH sh.a.

Ervis HAZIZI





Mbi zbatimin e Programit të Pajtueshmërisë në përputhje
me nenin 72 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”,
i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)

Përgatiti:

Ervis Hazizi

Zyrtari i Pajtueshmërisë

E-mail: ervis.hazizi@ossh.al

Website: www.ossh.al

Tirane Mars 2026

Përmbajtja

1. HYRJE	3
2. MODELI ADMINISTRATIV	4
3. MISIONI I SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES” (OSSH SH.A.)	6
4. PROGRAMI I PAJTUESHMERISË OSSH	7
5. PAVARËSIA E ORGANEVE DREJTUESE TË OSSH SH.A.	12
6. PËRJASHTIMI I SJELLJES DISKRIMINUESE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES	16
7. KONKURRENCA DHE MARRËDHENIET KOMERCIALE	17
8. ZBATIMI I PARIMEVE, TRANSPARENCËS DHE PAANSHMËRISË	19
9. E DREJTA E INFORMIMIT DHE MBROJTJA E INFORMACIONIT TË NDJESHËM	21
10. OFRIMI I SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA (SLA)	23
11. ZBATIMI DHE DETYRIMI PËR ZBATIM I PROGRAMIT TË PAJTUESHMERISË	25
12. POLITIKAT DHE PRAKTIKAT E SIGURISË KIBERNETIKE	28
13. ROLI I OSSH NË PROCESIN E LIBERALIZIMIT TË TREGUT	29
14. PERFORMANCA E RRJETIT DHE MENAXHIMI I HUMBJEVE TË ENERGJISË	31
15. MONITORIMI I OPERIMIT TË RRJETIT DHE SIGURIA E FURNIZIMIT	33
16. ZHVILLIMI I RRJETIT, INVESTIMET DHE MIRËMBAJTJA	36
17. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMERISË	41
18. RAPORTIMI I DETAJUAR NDAJ KËRKESAVE TË ERE	48
19. KONKLUSIONE	58

1. HYRJE

Raporti Vjetor i Pajtueshmërisë për vitin 2025 i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a. (OSSH sh.a.) paraqet vlerësimin e ushtruar nga Zyrtari i Pajtueshmërisë mbi zbatimin e Programit të Pajtueshmërisë dhe respektimin e detyrimeve ligjore dhe rregullatore nga ana e shoqërisë gjatë periudhës raportuese.

Ky raport hartohet në përputhje me nenin 72 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të akteve nënligjore dhe vendimeve rregullatore të Entit Rregullator të Energjisë (ERE). Ai mbështetet në Programin e Pajtueshmërisë së OSSH sh.a., miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 257, datë 21.12.2020, i cili përcakton masat organizative dhe procedurale për garantimin e ndarjes funksionale, trajtimit jo-diskriminues dhe mbrojtjes së informacionit konfidencial.

Zyrtari i Pajtueshmërisë është emëruar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës, datë 08.02.2023, dhe miratuar nga Bordi i ERE me Vendimin nr. 114, datë 27.03.2023. Në ushtrim të funksioneve të tij, Zyrtari monitoron zbatimin efektiv të Programit të Pajtueshmërisë, verifikon respektimin e dispozitave ligjore dhe rregullatore dhe informon autoritetin rregullator për çdo çështje që lidhet me integritetin dhe pavarësinë funksionale të operatorit të sistemit të shpërndarjes.

Gjatë vitit 2025, monitorimi është realizuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të pavarur, përmes analizës së dokumentacionit të brendshëm, procedurave operative, si dhe nëpërmjet bashkëpunimit me strukturat drejtuese menaxheriale dhe rajonale të shoqërisë.

Ky raport hartohet për herë të katërt në kuadër të ushtrimit të funksionit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë pranë OSSH sh.a. dhe përfshin analizën e masave të ndërmarra gjatë vitit 2025 në zbatim të Programit të Pajtueshmërisë. Në përputhje me kërkesat rregullatore, raporti i paraqitet Entit Rregullator të Energjisë (ERE) dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë brenda afatit ligjor, jo më vonë se data 31 mars 2026.

2. MODELI ADMINISTRATIV

Shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH sh.a.) është person juridik shqiptar, i themeluar nga aksionari i vetëm “OSHEE GROUP” sh.a., në përputhje me nenin 3, pika 1 dhe nenin 103 të Ligjit nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Shoqëria ushtron veprimtarinë në formën e shoqërisë aksionare me ofertë private dhe është themeluar më 28.03.2018, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L81530018E, me seli qendrore në Tiranë.

Modeli administrativ i OSSH sh.a. është ndërtuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe garanton ndarjen e qartë ndërmjet funksioneve mbikëqyrëse dhe atyre ekzekutive. Struktura organizative është konceptuar në mënyrë që të sigurojë pavarësi organizative, vendimmarrëse dhe funksionale, në përputhje me kërkesat e nenit 72 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe Programin e Pajtueshmërisë.

Në kuadër të parimit të ndarjes funksionale (unbundling), OSSH sh.a. ushtron aktivitetin e shpërndarjes në mënyrë të pavarur nga aktivitetet e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike të shoqërive të tjera të grupit. Vendimmarrja operationale, teknike dhe tregtare realizohet në mënyrë autonome, pa ndikime të jashtme që mund të cenojnë neutralitetin e operatorit ndaj përdoruesve të rrjetit.

▪ Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë dhe ushtron kompetencat e saj në përputhje me Ligjin nr. 9901/2008 dhe Statutin e OSSH sh.a. Ajo miraton strategjinë e zhvillimit, politikat kryesore, planet financiare, pasqyrat financiare vjetore, si dhe emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit dhe Administratorit.

Në kuadër të Programit të Pajtueshmërisë, roli i Asamblesë vlerësohet nga këndvështrimi i garantimit të pavarësisë funksionale dhe respektimit të parimeve të mosdiskriminimit. Monitorimi i ushtruar gjatë vitit 2025 nuk ka evidentuar ndërhyrje në vendimmarrjen operationale të shoqërisë që të cenojnë kërkesat e ndarjes funksionale.

▪ **Këshilli i Administrimit**

Këshilli i Administrimit përbëhet nga 5 anëtarë, të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme me mandat 3-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Gjatë vitit 2025, me Vendimin nr. 12, datë 10.07.2025, Asambleja e Përgjithshme vendosi zëvendësimin e anëtarit z. Artan Roko me znj. Juliana Melyshi për një mandat 3-vjeçar. Ky ndryshim u realizua në përputhje me legjislacionin dhe aktet themelore të shoqërisë.

Përbërja e Këshillit gjatë vitit 2025 ka qenë:

- Erald Hasanaj – Kryetar
- Fatjola Halilaj – Anëtare
- Bibjana Terolli – Anëtare
- Admirim Lakra – Anëtar
- Juliana Melyshi – Anëtare

Gjatë vitit 2025, Këshilli i Administrimit ka zhvilluar 7 mbledhje dhe ka miratuar 14 vendime, të cilat kanë trajtuar çështje ekonomiko-financiare, investime, marrëdhënie kontraktuale dhe administrim të burimeve njerëzore.

Në kuadër të monitorimit të Programit të Pajtueshmërisë, është verifikuar se ushtrimi i kompetencave nga Këshilli është realizuar brenda rolit të tij mbikëqyrës, pa ndërhyrë në kompetencat operacionale të Administratorit, duke respektuar ndarjen ndërmjet funksionit strategjik dhe atij ekzekutiv.

▪ **Administratori**

Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë dhe emërohet nga Asambleja e Përgjithshme për mandat 3-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Ai është përgjegjës për administrimin e përditshëm të veprimtarisë, zbatimin e vendimeve të Këshillit të Administrimit dhe përfaqësimin ligjor të shoqërisë.

Kompetencat e Këshillit të Administrimit nuk ushtrohen nga Administratori dhe anasjelltas, duke garantuar ndarje të qartë ndërmjet funksionit mbikëqyrës dhe atij ekzekutiv.

- Me Vendimin nr. 7491/1, datë 29.10.2025, Asambleja e Përgjithshme riemëroi z. Blendian Dalipi në pozicionin e Administratorit për një mandat 3-vjeçar, deri më 29.10.2028.

Nga analiza e kryer në kuadër të monitorimit të Programit të Pajtueshmërisë rezulton se ndryshimet e realizuara gjatë vitit 2025 në nivel administrativ janë kryer në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nuk kanë cenuar pavarësinë organizative dhe funksionale të OSSH sh.a., në përputhje me kërkesat e nenit 72 të Ligjit nr. 43/2015.

3. MISIONI I SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES” (OSSH SH.A.)

Misioni i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a. (OSSH sh.a.) është garantimi i ofrimit të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike në mënyrë të sigurt, të qëndrueshme, efikase, transparente dhe jo-diskriminuese në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) duke synuar njëkohësisht rritjen e cilësisë së shërbimit dhe eficiencës së rrjetit të shpërndarjes.

Në përputhje me nenin 70 të këtij ligji, OSSH sh.a. është përgjegjëse për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, duke garantuar funksionimin e tij në mënyrë të sigurt dhe të besueshme, si dhe përmbushjen e kërkesës për energji elektrike brenda territorit të shërbimit.

▪ Ushtrimi i funksionit të shpërndarjes

OSSH sh.a. ushtron funksionin e shpërndarjes në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të përdoruesve të rrjetit.

Në këtë kuadër, shoqëria është përgjegjëse për:

- operimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjetit të shpërndarjes.
- zhvillimin e rrjetit në përputhje me nevojat e konsumatorëve dhe zhvillimin ekonomik.
- lidhjen në rrjet të konsumatorëve dhe prodhuesve në kushte objektive, transparente dhe jo-diskriminuese.
- sigurimin e aksesit të barabartë në rrjet.
- administrimin e të dhënave të matjes dhe mbrojtjen e informacionit të ndjeshëm tregtar.
- garantimin e aksesit të furnizuesve në të dhënat e matjes, në përputhje me rregulloret e ERE.

Ushtrimi i këtij funksioni realizohet në mënyrë të pavarur nga aktivitetet e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike, duke garantuar neutralitet funksional dhe shmangien e çdo trajtimi preferencial.

▪ Lidhja në rrjet e burimeve gjeneruese dhe vetëprodhuesve

Në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator, OSSH sh.a. garanton trajtimin e kërkesave për lidhje në rrjet të burimeve gjeneruese, përfshirë burimet dytësore dhe vetëprodhuesit, në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese.

Procedurat e shqyrtimit të kërkesave bazohen në:

- kriteret teknike të njëjta për të gjithë aplikantët.
- afate të përcaktuara për trajtimin e kërkesave.
- transparencë në përcaktimin e kostove të lidhjes.
- dokumentim të plotë të procesit të vendimmarrjes.

Refuzimi i lidhjes në rrjet mund të ndodhë vetëm për arsye objektive dhe teknike, të justifikuara dhe të dokumentuara, në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret e miratuara nga ERE.

▪ **Kodi i Shpërndarjes**

Kodi i Shpërndarjes përbën dokumentin bazë rregullator që përcakton kërkesat teknike dhe procedurale për planifikimin, operimin, mirëmbajtjen dhe aksesin në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me nenin 73 të Ligjit nr. 43/2015.

OSSH sh.a. ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Kodin e Shpërndarjes në fuqi, duke respektuar parimet e sigurisë së sistemit, transparencës dhe trajtimit të barabartë të përdoruesve të rrjetit.

Në kuadër të zhvillimeve të tregut dhe procesit të liberalizimit, është ndërmarrë procesi i rishikimit dhe përditësimit të Kodit të Shpërndarjes, në përputhje me procedurat e konsultimit dhe miratimit nga ERE

▪ **Administrimi dhe verifikimi i matësve**

OSSH sh.a. është përgjegjëse për operimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e pajisjeve të matjes në sistemin e shpërndarjes, duke garantuar saktësinë, besueshmërinë dhe integritetin e të dhënave të matjes.

Procesi i verifikimit realizohet në mënyrë jo-diskriminuese dhe përfshin:

- verifikimin fillestar të pajisjeve të reja.
- verifikimin periodik sipas kërkesave teknike.
- trajtimin e kërkesave për kontroll të saktësisë së matjes.
- dokumentimin e çdo ndërhyrjeje.
- respektimin e të drejtës së ankimit.

Çdo konstatim apo refuzim bazohet vetëm në evidenca teknike të dokumentuara, pa trajtim selektiv ndaj ndonjë kategorie përdoruesish.

4. PROGRAMI I PAJTUESHMERISË OSSH

Kuadri ligjor dhe baza rregullatore:

Programi i Pajtueshmërisë i OSSH sh.a. hartohet dhe zbatohet në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi për operatorët e sistemit të shpërndarjes, duke synuar garantimin e: (i) ndarjes funksionale dhe vendimmarrëse (unbundling), (ii) trajtimit jodiskriminues të përdoruesve të rrjetit dhe subjekteve të tregut, si dhe (iii) mbrojtjes së informacionit tregtar konfidencial dhe parandalimit të deformimeve të konkurrencës.

Programi është miratuar nga Këshilli i Administrimit i OSSH sh.a. me Vendimin nr. 18/2020 dhe nga Bordi i ERE me Vendimin nr. 257, datë 21.12.2020, pas reflektimit të komenteve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Gjatë procesit të miratimit janë integruar elemente thelbësore, si: forcimi i ndalimit të trajtimit preferencial ndaj shoqërive të lidhura, përcaktimi i kompetencave të Zyrtarit të Pajtueshmërisë, garantimi i aksesit në informacion, mekanizmi i raportimit konfidencial/anonim dhe parashikimi i masave disiplinore për shkelje.

Objektivat dhe përmbajtja thelbësore e Programit

Programi përcakton detyrimet dhe masat për:

- ndarjen juridike, funksionale dhe financiare të aktivitetit të shpërndarjes.
- garantimin e pavarësisë organizative dhe vendimmarrëse të OSSH sh.a..
- sigurimin e aksesit jodiskriminues në rrjet dhe zbatimin e procedurave transparente.
- mbrojtjen e informacionit tregtar konfidencial/komercialisht sensitiv.
- parandalimin e ndërsuvencionimit dhe rreziqeve të deformimit të konkurrencës.

▪ Roli dhe Kompetencat e Zyrtarit të Pajtueshmërisë

Zyrtari i Pajtueshmërisë ushtron funksionin në mënyrë të pavarur dhe monitoron zbatimin e Programit të Pajtueshmërisë, duke raportuar mbi përputhshmërinë dhe duke rekomanduar masa për forcimin e kontrollit të brendshëm.

Në ushtrimin e funksionit, Zyrtari i Pajtueshmërisë, ndër të tjera:

- monitoron respektimin e detyrimeve për ndarjen organizative, funksionale dhe vendimmarrëse të OSSH sh.a.;
- verifikon zbatimin e parimit të mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të përdoruesve të rrjetit;
- kontrollon respektimin e ndarjes së llogarive dhe parandalimin e ndërsuvencionimit;
- identifikon raste të mundshme konflikti interesi;
- verifikon respektimin e rregullave konkurruese dhe parimit të çmimit të tregut për shërbimet e përbashkëta (SLA);
- propozon rekomandime për forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm.

Në përputhje me Programin, Zyrtari i Pajtueshmërisë nuk mban dhe nuk ushtron, drejtpërdrejt apo tërthorazi, asnjë pozicion ose interes profesional në subjekte që ushtrojnë veprimtari prodhimi apo furnizimi me energji elektrike, duke garantuar objektivitet dhe paanshmëri.

▪ Ushtrimi i funksionit gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, funksioni i Zyrtarit të Pajtueshmërisë është ushtruar në mënyrë të plotë dhe efektive, nëpërmjet:

(a) Pjesëmarrjes në procese vendimmarrëse:

Zyrtari i Pajtueshmërisë është informuar dhe ka marrë pjesë, kur është vlerësuar e nevojshme, në mbledhjet e Këshillit të Administrimit dhe në mbledhje të strukturave menaxheriale qendrore dhe rajonale, me qëllim monitorimin e proceseve vendimmarrëse dhe garantimin e ndarjes funksionale.

Kjo ka mundësuar monitorim në kohë reale të vendimmarrjes, verifikim të pavarësisë së OSSH sh.a. në raport me shoqëritë e tjera të grupit, si dhe parandalim të rreziqeve të konfliktit të interesit apo trajtimit diskriminues.

(b) Aksesit në informacion dhe dokumentacion:

Në ushtrimin e funksionit, Zyrtari i Pajtueshmërisë ka pasur akses të plotë në dokumentacionin administrativ/organizativ, proceset vendimmarrëse, të dhëna teknike e operative, informacion financiar dhe rregullator, si dhe dokumentacionin për shërbimet e përbashkëta (SLA), në masën e nevojshme për verifikimin e ndarjes funksionale.

Akresi është ushtruar duke respektuar detyrimet për konfidencialitet dhe mbrojtjen e informacionit komercial sensitiv, si dhe kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjatë vitit raportues nuk janë konstatuar kufizime që do të cenonin pavarësinë funksionale të Zyrtarit.

(c) Rekomandimeve dhe masave parandaluese:

Në kuadër të rolit monitorues dhe parandalues, janë adresuar rekomandime për forcimin e transparencës, rritjen e ndërgjegjësisë institucionale dhe përmirësimin e gjurmueshmërisë së proceseve, përfshirë:

- përmirësimin e transparencës përmes zhvillimit të faqes zyrtare;
- krijimin/funksionalizimin e rubrikës “Raporto te Zyrtari i Pajtueshmërisë” si mekanizëm sinjalizimi konfidencial/anonim;
- forcimin e dokumentimit të proceseve vendimmarrëse;
- sensibilizimin e strukturave menaxheriale mbi detyrimet që rrjedhin nga ndarja funksionale.

Rekomandimet janë marrë në konsideratë nga strukturat përkatëse dhe janë reflektuar në praktikën organizative, duke kontribuar në zbatim të dokumentuar dhe të auditueshëm të Programit.

▪ **Metodologjia e monitorimit gjatë vitit 2025**

Monitorimi gjatë vitit 2025 është realizuar mbi një qasje të strukturuar, e orientuar drejt:

- verifikimit të ndarjes funksionale dhe vendimmarrëse;
- garantimit të trajtimit jodiskriminues të përdoruesve të rrjetit;
- mbrojtjes së informacionit komercial sensitiv;

Në këtë kuadër, janë kryer:

1. **mbledhje dhe analizë dokumentacioni** (procedura të brendshme, kushte aksesit në rrjet, marrëdhënie me furnizuesit, ndarje kostosh dhe SLA, korrespondencë zyrtare dhe akte vendimmarrëse).

2. **verifikim i proceseve të aksesit dhe lidhjeve në rrjet** (kërkesa për lidhje, afate trajtimi, zbatim tarifash të miratuara).
3. **monitorim i administrimit të informacionit komercial sensitiv** (ndarja e informacionit publik/konfidencial dhe zbatimi i procedurave mbrojtëse).
4. **mbikëqyrje e marrëdhënieve me shoqëritë e lidhura** (SLA të vitit 2025 dhe metodologji alokimi kostosh), me fokus shmangien e çdo efekti subvencionues ndaj aktiviteteve konkurruese.

▪ **Rezultatet e monitorimit gjatë vitit 2025**

Nga procesi i monitorimit rezulton se:

- Nuk janë konstatuar raste të trajtimit diskriminues sistematik ndaj përdoruesve të rrjetit apo subjekteve të tregut.
- Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të paadresuar në nivel menaxherial apo operativ.
- Nuk është konstatuar ndër-subvencionim midis aktivitetit të rregulluar të shpërndarjes dhe aktiviteteve të tjera të shoqërisë vertikalisht të integruar.
- Vendimmarrja në lidhje me operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit është ushtruar në përputhje me kërkesat e ndarjes funksionale.

▪ **Masa për forcimin e transparencës dhe kanaleve të raportimit**

Me qëllim rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe gjurmueshmërisë së proceseve, gjatë vitit 2025 është rekomanduar forcimi i mekanizmave të raportimit dhe monitorimit për rastet e mundshme të tejkalimit të afateve në trajtimin e kërkesave për lidhje në rrjet, si rrezik potencial për devijime procedurale dhe trajtim të pabarabartë.

Në këtë drejtim, është orientuar përdorimi i kanaleve zyrtare të komunikimit të shoqërisë, përfshirë rubrikën e dedikuar “Raporto/Denonco pranë Zyrtarit të Pajtueshmërisë”, ku çdo sinjalizim trajtohet në mënyrë konfidenciale dhe verifikohet në përputhje me Programin dhe kuadrin rregullator.

▪ **Zbatimi i Kërkesave të Direktivës 2009/72/EC:**

Gjatë vitit 2025, OSSH sh.a. ka vijuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Direktiva 2009/72/EC, e transpozuar në legjislacionin kombëtar përmes Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, duke garantuar respektimin e parimeve të ndarjes ligjore dhe funksionale (unbundling), trajtimit jo-diskriminues dhe transparencës në ushtrimin e veprimtarisë së operatorit të sistemit të shpërndarjes.

Në kuadër të monitorimit të kryer gjatë vitit raportues, është verifikuar se pavarësia organizative dhe vendimmarrëse e OSSH sh.a. është ushtruar në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi, përfshirë ndarjen e strukturave menaxheriale dhe të llogarive nga aktivitetet e prodhimit dhe furnizimit me

energji elektrike. Nuk janë identifikuar ndërhyrje apo ndikime me efekt material nga subjekte që ushtrojnë veprimtari konkurruese, të cilat do të cenonin integritetin e ndarjes funksionale.

OSSH sh.a. ka garantuar akses të barabartë dhe jo-diskriminues në rrjet për të gjithë përdoruesit, duke zbatuar procedura të njëjta dhe transparente për lidhjen, përdorimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të rrjetit, në përputhje me rregulloret e miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE).

Janë zbatuar masa për mbrojtjen e informacionit tregtar konfidencial dhe komercialisht sensitiv, duke garantuar që asnjë subjekt i lidhur të mos përfitojë avantazh konkurrues përmes aksesit në informacion të privilegjuar.

Në këtë kuadër, OSSH sh.a. ka vijuar përmirësimin e praktikave të monitorimit dhe raportimit, përfshirë proceset që lidhen me integrimin e vetëprodhuesve (prosumers) në rrjet, me qëllim garantimin e stabilitetit të sistemit dhe përputhshmërisë së vazhdueshme me zhvillimet e tregut dhe kërkesat e acquis të Komunitetit të Energjisë.

▪ **Vlerësimet nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për OSSH**

Sipas Raportit Vjetor të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (Annual Implementation Report, nëntor 2025), OSSH sh.a. vlerësohet pozitivisht për respektimin e parimit të ndarjes ligjore dhe funksionale (unbundling) nga aktivitetet e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike.

Në raport evidentohen gjithashtu elemente që lidhen me:

- raportimin e rregullt vjetor të pajtueshmërisë pranë Entit Rregullator të Energjisë (ERE);
- miratimin nga ERE të Raportit të Pajtueshmërisë për vitin 2024, duke reflektuar vazhdimësinë e praktikave raportuese dhe përputhshmërinë me kërkesat rregullatore.

Nga ana tjetër, në raport theksohet se Kodi i Shpërndarjes, i miratuar në vitin 2008, vijon të jetë në fuqi dhe identifikohet si një nga elementet që kërkon përditësim të mëtejshëm në përputhje me zhvillimet e tregut dhe acquis të Komunitetit të Energjisë.

Në këtë kuadër, OSSH sh.a. ka identifikuar si prioritet përmbylljen e procesit të rishikimit dhe përditësimit të Kodit të Shpërndarjes brenda vitit 2026, në funksion të përafrimit të mëtejshëm me standardet e Komunitetit të Energjisë dhe zhvillimet e sektorit.

▪ **Angazhimi rajonal dhe bashkëpunimi në kuadër të ECDSO-E**

Gjatë vitit 2025, OSSH sh.a., si anëtare e ECDSO-E (Energy Community Distribution System Operators Coordination), ka marrë pjesë në aktivitetet dhe diskutimet e këtij forumi rajonal.

Kontributi është përqendruar në:

- sfidat e tranzicionit energjetik
- integrimin e burimeve të rinovueshme në rrjetin e shpërndarjes
- menaxhimin e vetëprodhuesve (prosumers) dhe ndikimin e tyre në operimin e rrjetit
- reduktimin e humbjeve teknike dhe jo-teknike
- zhvillimin e infrastrukturës për automjetet elektrike (EV).

Ky angazhim ka mundësuar shkëmbimin e praktikave më të mira rajonale, koordinimin mbi çështje me interes të përbashkët dhe përafrimin e mëtejshëm të praktikave të OSSH sh.a. me standardet dhe direktivat e Komunitetit të Energjisë.

5. PAVARËSIA E ORGANEVE DREJTUESE TË OSSH SH.A.

Në përputhje me nenin 72 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, OSSH sh.a. ushtron aktivitetin e shpërndarjes si person juridik i ndarë brenda një shoqërie vertikalisht të integruar, duke garantuar pavarësi organizative, funksionale dhe vendimmarrëse në operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes.

Struktura drejtuese dhe modeli administrativ janë ndërtuar në mënyrë që të sigurojnë ushtrimin e aktivitetit të rregulluar pa ndërhyrje nga aktivitetet e prodhimit dhe furnizimit, duke garantuar integritet institucional, paanshmëri dhe trajtim jodiskriminues të përdoruesve të rrjetit.

▪ Marrëdhënia me Shoqërinë Vertikalisht të Integruar

Marrëdhënia ndërmjet OSSH sh.a. dhe OSHEE Group sh.a. rregullohet nga Statuti i shoqërisë, veçanërisht neni 25, i cili përcakton kufijtë e kompetencave ndërmjet shoqërisë mëmë dhe operatorit të sistemit të shpërndarjes.

Në zbatim të këtij kuadri:

- OSSH ka të drejta të plota vendimmarrëse mbi asetet e rrjetit të shpërndarjes.
- Shoqëria mëmë nuk jep udhëzime për veprimtarinë e përditshme operacionale.
- Administratori i OSHEE Group nuk kufizon kompetencat e Administratorit të OSSH.
- OSHEE Group ushtron vetëm mbikëqyrje ekonomike në nivel strategjik.

Ky organizim garanton autonominë operacionale të OSSH dhe shmang çdo ndërhyrje që mund të cenojë ndarjen funksionale të aktivitetit të shpërndarjes.

▪ Ndarja ligjore dhe funksionale

OSSH sh.a. funksionon si person juridik i ndarë nga subjektet që ushtrojnë aktivitet prodhimi dhe furnizimi me energji elektrike.

Ndarja funksionale është realizuar përmes:

- transferimit të aseteve dhe detyrimeve të lidhura me aktivitetin e shpërndarjes.
- ndarjes së pasqyrave financiare.
- krijimit të strukturave organizative të dedikuara.
- planifikimit autonom të investimeve.

Procesi i ndarjes është verifikuar nga auditues të pavarur (I.L.D-99 Audit, 10.12.2020), të cilët kanë konfirmuar përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

▪ **Ndarja e menaxhmentit**

Personat përgjegjës për menaxhimin e OSSH:

- nuk marrin pjesë në strukturat drejtuese të subjekteve të prodhimit apo furnizimit.
- nuk ushtrojnë funksione të dyfishta në shoqëri konkurruese.
- nuk përfitojnë kompensim të lidhur me performancën e subjekteve të furnizimit.

Ky organizim garanton shmangien e konfliktit të interesit dhe ruan pavarësinë vendimmarrëse të operatorit të sistemit të shpërndarjes.

▪ **Ndarja financiare dhe performanca ekonomike**

OSSH mban llogari të ndara dhe zbaton kërkesat për shmangien e ndërsuvencionimit ndërmjet aktivitetit të rregulluar të shpërndarjes dhe aktiviteteve të furnizimit (FSHU sh.a. dhe FTL sh.a.), në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

Pasqyrat financiare auditohen nga auditues të pavarur, duke garantuar transparencë dhe gjurmueshmëri të plotë të të ardhurave dhe kostove të aktivitetit të rregulluar. Pasqyrat financiare të vitit 2024 janë audituar më 29.12.2025, ndërsa pasqyrat e vitit 2025 janë në proces auditimi.

Gjatë vitit 2025 është evidentuar:

- përmirësim i performancës financiare krahasuar me vitin 2024
- rritje e të ardhurave nga tarifa e shpërndarjes
- ulje e nivelit të humbjeve në rrjet përtej objektivave të planifikuara
- rezultat financiar pozitiv.

Auditimi i pavarur dhe ndarja e llogarive përbëjnë mekanizma thelbësorë për garantimin e përputhshmërisë me kërkesat e nenit 72 të Ligjit nr. 43/2015 dhe për shmangien e çdo forme ndërsuvencionimi.

▪ **Transferimi dhe administrimi i burimeve njerëzore**

Në zbatim të reformës strukturore të sektorit të energjisë elektrike, në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 dhe VKM nr. 519, datë 13.07.2016, u realizua ndarja e aktivitetit të shpërndarjes nga aktivitetet e furnizimit, në kuadër të modelit të liberalizimit të tregut.

Me Urdhrin e Aksionerit nr. 157, datë 12.02.2018, u krijuan tre shoqëri të veçanta brenda OSHEE Group:

- OSSH sh.a. – operator i sistemit të shpërndarjes.
- FSHU sh.a. – furnizuesi i shërbimit universal.
- FTL sh.a. – furnizuesi i tregut të lirë.

Krijimi i këtyre shoqërive materializoi ndarjen ligjore dhe funksionale (unbundling), duke shmangur konfliktin e interesit ndërmjet aktivitetit monopol natyror të shpërndarjes dhe aktiviteteve konkurruese të furnizimit.

▪ **Transferimi i marrëdhënieve të punës**

Me efekt nga 01.01.2020, në zbatim të nenit 138 e vijues të Kodit të Punës, marrëdhëniet e punës së punonjësve përkatës u transferuan nga OSHEE sh.a. tek OSSH sh.a., me ruajtjen e të drejtave dhe kushteve kontraktore.

Procesi u realizua mbi bazë aktesh formale të aksionerit, me njoftim individual për çdo punonjës dhe dokumentim të plotë në sistemet e personelit.

▪ **Përputhshmëria me ndarjen funksionale**

Transferimi i stafit përbën element thelbësor të zbatimit të nenit 72 të Ligjit nr. 43/2015, duke garantuar:

- ndarje juridike dhe organizative nga FSHU dhe FTL.
- struktura menaxheriale dhe operacionale të veçanta.
- mungesë ndërthurjeje funksionale me aktivitetet e furnizimit.
- mosangazhim të stafit të OSSH në veprimtari furnizimi.

Ky organizim siguron respektimin e parimit të unbundling-ut dhe trajtimin jodiskriminues të përdoruesve të rrjetit.

▪ **Monitorimi gjatë vitit 2025**

Politikat e burimeve njerëzore zbatohen mbi bazë procedurash transparente dhe standarde etike.

Gjatë vitit 2025:

- janë monitoruar emërimet dhe lëvizjet e stafit.
- është verifikuar respektimi i ndarjes funksionale.
- nuk janë konstatuar raste të konfliktit të interesit apo cenimit të ndarjes organizative.

Procesi është zhvilluar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe me Programin e Pajtueshmërisë.

Struktura e re organizative nuk ka parashikuar ndryshime në numrin total të punonjësve të shoqërisë. Ndryshimet kanë qenë me natyrë organizative dhe funksionale, pa prekur ndarjen ligjore, funksionale apo menaxheriale të OSSH sh.a. brenda shoqërisë vertikalisht të integruar.

Nga analiza e kryer në kuadër të Programit të Pajtueshmërisë rezulton se ristrukturimi nuk ka cenuar pavarësinë organizative dhe vendimmarrëse të operatorit dhe nuk ka krijuar ndërthurje funksionale me aktivitetet e prodhimit apo furnizimit, në përputhje me kërkesat e nenit 72 të Ligjit nr. 43/2015.

6. PËRJASHTIMI I SJELLJES DISKRIMINUESE NË RRJETIN E SHPËRDARJES

Në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe me Programin e Pajtueshmërisë të miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE), OSSH sh.a. siguron qasje transparente dhe jodiskriminuese në rrjetin e shpërndarjes për të gjithë përdoruesit e rrjetit.

Qasja në rrjet, përfshirë lidhjen (kyçjen), përdorimin e kapaciteteve dhe aplikimin e tarifave, realizohet mbi bazën e kritereve teknike dhe procedurale të njëjta për të gjithë aplikantët, tarifave të miratuara nga ERE, procedurave të standardizuara dhe transparente, si dhe respektimit të afateve të përcaktuara për trajtimin e kërkesave.

Kostot që i ngarkohen përdoruesve për kyçjen në sistemin e shpërndarjes dhe për përdorimin e tij përcaktohen dhe aplikohen në përputhje me kuadrin rregullator të miratuar nga ERE, duke garantuar trajtim të barabartë dhe shmangien e çdo forme trajtimi preferencial.

▪ Mekanizmat për parandalimin e diskriminimit

Gjatë vitit 2025, OSSH sh.a. ka zbatuar mekanizma konkretë për garantimin e trajtimit jodiskriminues të përdoruesve të rrjetit, ndër të cilët:

- aplikimin e njëjtë të kushteve teknike për lidhjet e reja në rrjet
- monitorimin e afateve të trajtimit të aplikimeve
- kontrollin e zbatimit korrekt të tarifave të rregulluara
- administrimin e ndarë dhe të mbrojtur të informacionit komercial sensitiv
- funksionalizimin e kanalit të raportimit “Raporto pranë Zyrtarit të Pajtueshmërisë”.

Procedurat e aplikuar janë të njëjta për konsumatorët familjarë, subjektet tregtare, furnizuesit dhe burimet gjeneruese, pa trajtim diferencues apo selektiv.

▪ Transparenca dhe trajtimi i ankesave

OSSH sh.a. ka garantuar transparencë në proceset që lidhen me aksesin në rrjet përmes publikimit të rregulloreve dhe kushteve teknike në faqen zyrtare të shoqërisë, ofrimit të informacionit mbi procedurat e lidhjes dhe dokumentacionin e kërkuar, si dhe funksionimit të mekanizmave për trajtimin e ankesave dhe kërkesave të përdoruesve të rrjetit.

Çdo ankesë apo sinjalizim trajtohet mbi bazën e dokumentacionit përkatës dhe kritereve objektive, në përputhje me procedurat e miratuara, duke garantuar trajtim të barabartë dhe të paanshëm.

▪ **Monitorimi gjatë vitit 2025**

Në kuadër të Programit të Pajtueshmërisë, Zyrtari i Pajtueshmërisë ka ushtruar monitorim mbi proceset që lidhen me lidhjen në rrjet, trajtimin e aplikimeve për burime gjeneruese dhe respektimin e afateve procedurale, bazuar në informacionin dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, si dhe në pjesëmarrjen në procese përkatëse vendimmarrëse.

Monitorimi është realizuar mbi bazë risku dhe në mënyrë selektive, duke u fokusuar në elementet me impakt më të lartë për garantimin e trajtimit jodiskriminues dhe transparencës së proceseve.

Bazuar në monitorimin e ushtruar dhe në informacionin e disponueshëm gjatë vitit 2025, nuk janë evidentuar raste të trajtimit diskriminues ndaj përdoruesve të rrjetit. Proceset e lidhjes dhe përdorimit të rrjetit rezultojnë të jenë zhvilluar mbi bazën e kritereve të njëjta dhe transparente, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

Ky vlerësim nuk përbën një auditim të plotë të të gjitha proceseve operative, por reflekton rezultatet e monitorimit të ushtruar në kuadër të funksionit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë.

7. KONKURRENCA DHE MARRËDHENIET KOMERCIALE

Në përputhje me Programin e Pajtueshmërisë dhe nenin 72 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, aktiviteti i OSSH sh.a. ushtrohet në mënyrë që të mos kufizojë, shtrembërojë apo ndikojë në konkurrencën e drejtë në tregun e energjisë elektrike.

Në këtë kuadër, OSSH siguron qasje jodiskriminuese në të gjitha proceset që mund të kenë ndikim në konkurrencë, përfshirë:

- kërkesat teknike për kyçje në rrjet;
- procedurat dhe afatet kohore për trajtimin e kërkesave;
- standardizimin e kushteve kontraktuale dhe komerciale;
- kostot e kyçjes dhe përdorimit të rrjetit;
- cilësinë e shërbimit në mirëmbajtjen dhe rregullimin e defekteve në rrjet.

▪ **Kërkesat teknike dhe procedurat e kyçjes**

Gjatë vitit 2025, OSSH sh.a. ka zbatuar kritere teknike të njëjta dhe të standardizuara për të gjithë aplikantët që kërkojnë lidhje në rrjet, pa dallim furnizuesi, kategorie përdoruesi apo forme pronësie.

Procedurat për shqyrtimin e kërkesave për kyçje janë të dokumentuara, të unifikuara dhe të publikuara, ndërsa afatet kohore për trajtimin e tyre janë të përcaktuara dhe të monitoruara. Procesi i vendimmarrjes është i dokumentuar dhe i gjurmueshëm.

Nga monitorimi i kryer gjatë vitit 2025 nuk janë konstatuar trajtime preferenciale apo vonesa selektive që mund të cenojnë konkurrencën në treg.

▪ **Standardizimi i kushteve kontraktuale dhe komerciale**

Kontratat për akses dhe lidhje në rrjet aplikohen në formë standarde dhe me kushte të njëjta për të gjithë përdoruesit. Kushtet kontraktuale dhe komerciale janë në përputhje me aktet rregullatore dhe nuk përmbajnë dispozita që favorizojnë ndonjë subjekt të caktuar.

Tarifat dhe kostot e kyçjes aplikohen në përputhje me vendimet e miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë dhe bazohen në parimin e kostos reale të shërbimit, pa krijuar barriera artificiale për akses në rrjet.

Gjatë vitit raportues nuk janë evidentuar raste të aplikimit selektiv apo diskriminues të kushteve komerciale.

▪ **Cilësia e shërbimit dhe mirëmbajtja e rrjetit**

OSSH sh.a. ofron shërbime mirëmbajtjeje dhe ndërhyrjeje në rrjet mbi bazë standardesh të njëjta për të gjithë përdoruesit. Koha e reagimit ndaj defekteve, ndërhyrjet teknike dhe trajtimi i problemeve në rrjet realizohen sipas kriterëve objektive dhe të miratuara, pa trajtim preferencial.

Cilësia e shërbimit monitorohet në përputhje me rregulloret e miratuara nga ERE për standardet e cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit, duke garantuar barazi në trajtim dhe transparencë në raportim.

▪ **Marrëdhëniet me shoqëritë e lidhura dhe operatorët e tregut**

Marrëdhëniet ndërmjet OSSH sh.a. dhe shoqërive të tjera të grupit realizohen në përputhje me parimin e ndarjes funksionale dhe me rregullat për shmangien e konfliktit të interesit.

Nuk konstatohet ndërhyrje në vendimmarrjen operationale të OSSH dhe nuk aplikohet trajtim preferencial në aksesin në rrjet ndaj subjekteve të lidhura.

Informacioni komercial sensitiv administrohet në mënyrë të ndarë dhe të mbrojtur, duke shmangur çdo avantazh konkurrues për subjektet e lidhura. Shkëmbimi i informacionit teknik me operatorë të tjerë të tregut realizohet mbi baza objektive, të njëjta dhe jo selektive.

8. ZBATIMI I PARIMEVE, TRANSPARENCËS DHE PAANSHMËRISË

Në përputhje me Programin e Pajtueshmërisë dhe nenin 72 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, OSSH sh.a. ka vijuar gjatë vitit 2025 zbatimin e parimeve të objektivitetit, transparencës dhe paanshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë operacionale dhe komerciale.

Këto parime përbëjnë element thelbësor për garantimin e trajtimit jodiskriminues të përdoruesve të rrjetit dhe për ruajtjen e integritetit rregullator të operatorit.

▪ Objektiviteti në vendimmarrje

Gjatë vitit 2025, vendimmarrja në lidhje me:

- kërkesat për kyçje në rrjet.
- aplikimin e kushteve teknike.
- trajtimin e ankesave.
- ndërhyrjet dhe mirëmbajtjen e rrjetit.

Proceset janë zhvilluar pa ndikime të jashtme dhe pa favorizim të ndonjë subjekti, përfshirë subjektet e lidhura brenda grupit.

▪ Transparenca

OSSH sh.a. ka garantuar transparencë përmes:

- publikimit të procedurave dhe kushteve teknike për lidhje në rrjet.
- informimit të përdoruesve mbi dokumentacionin dhe afatet procedural.
- raportimit periodik pranë Enti Rregullator i Energjisë mbi treguesit e performances.
- mbështetjes së proceseve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Informacioni i nevojshëm për përdoruesit është bërë i aksesueshëm në mënyrë të qartë dhe të njëjtë për të gjitha palët e interesuara.

▪ Paanshmëria

Gjatë vitit raportues, OSSH sh.a. ka siguruar:

- trajtim të barabartë të të gjithë përdoruesve të rrjetit
- aplikim uniform të kushteve kontraktuale dhe teknike
- reagim të njëjtë ndaj defekteve dhe ndërprerjeve, sipas kritereve objektive të operimit të rrjetit.

Nuk është konstatuar trajtim preferencial apo selektiv në ofrimin e shërbimeve.

▪ Trajtimi i ankesave dhe mekanizmat e mbikëqyrjes

Njësitë përgjegjëse kanë trajtuar çdo ankesë të adresuar ndaj shoqërisë me ndershmëri dhe objektivitet, duke garantuar:

- regjistrimin dhe dokumentimin e plotë të ankesave.
- respektimin e afateve për kthimin e përgjigjeve.
- ruajtjen e konfidencialitetit dhe anonimitetit, kur kërkohet.

Gjatë vitit 2025 është administruar një bazë e dhënash për regjistrimin dhe ndjekjen e ankesave, duke siguruar gjurmueshmëri dhe kontroll të brendshëm të procesit.

▪ **Monitorimi në kuadër të Programit të Pajtueshmërisë**

Në kuadër të Programit të Pajtueshmërisë, Zyrtari i Pajtueshmërisë ka ushtruar gjatë vitit 2025 monitorim të vazhdueshëm dhe të pavarur mbi:

- trajtimin e kërkesave dhe ankesave të përdoruesve të rrjetit;
- respektimin e procedurave të brendshme dhe kuadrit rregullator në fuqi;
- garantimin e të drejtave të përdoruesve të rrjetit dhe shmangien e çdo kufizimi apo trajtimi të pabarabartë.

Në rastet e evidentuara të tejkalimit të afateve procedurale, Zyrtari i Pajtueshmërisë ka kërkuar shpjegime të arsyetuara nga strukturat përkatëse, të cilat janë analizuar për të vlerësuar nëse vonesat kishin natyrë objektive apo përbënin risk për trajtim të pabarabartë të përdoruesve të rrjetit

Çdo sinjalizim i adresuar përmes kanaleve zyrtare të komunikimit, përfshirë rubrikën “Raporto/Denonco pranë Zyrtarit të Pajtueshmërisë” dhe komunikimet elektronike, është regjistruar, verifikuar dhe ndjekur në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, me qëllim zgjidhjen në kohë dhe parandalimin e çdo devijimi procedural.

Gjatë vitit 2025, nëpërmjet rubrikës “Raporto/Denonco pranë Zyrtarit të Pajtueshmërisë”, është administruar një rast sinjalizimi nga një përdorues i rrjetit, i cili lidhej me problematika të cilësisë së furnizimit me energji elektrike, konkretisht luhatje të tensionit.

Rasti është trajtuar në përputhje me procedurat në fuqi, përmes delegimit pranë strukturave përgjegjëse për verifikim teknik në terren dhe analizë të situatës. Në vijim të shqyrtimit, janë administruar të dhëna operative mbi stakimet dhe ndërhyrjet në linjat përkatëse dhe në fidrat e furnizimit, nga të cilat rezultoi se ndërprerjet dhe luhatjet kanë pasur natyrë teknike dhe janë shkaktuar nga faktorë operativë të rrjetit (manovra në transformatorë, ndërhyrje të planifikuara, defekte apo masa sigurie).

Nga analiza e kryer rezultoi se problematika e raportuar nuk lidhet me trajtim diskriminues apo devijime nga Programi i Pajtueshmërisë, por me kushte teknike të operimit të rrjetit. Megjithatë, raste të tilla kërkojnë monitorim të vazhdueshëm për të garantuar standardet e cilësisë së shërbimit dhe trajtimin e barabartë të përdoruesve të rrjetit.

Nga analiza e dokumentacionit dhe monitorimi i ushtruar gjatë vitit 2025 rezultoi se nuk janë evidentuar shkelje sistematike të parimeve të objektivitetit, transparencës dhe paanshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së OSSH sh.a.

Gjithashtu, në kuadër të zhvillimeve rregullatore të tregut të energjisë elektrike dhe përafrimit me acquis të Bashkimit Europian, vlerësohet rëndësia e Rregullores REMIT (Regulation on Wholesale Energy Market Integrity and Transparency), e cila synon garantimin e integritetit dhe transparencës së tregut të energjisë. Në nivel kombëtar, zbatimi i kësaj rregulloreje realizohet nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE), si autoriteti përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e tregut. Në këtë kuadër, OSSH sh.a., në cilësinë e operatorit të sistemit të shpërndarjes, kontribuon në respektimin e parimeve të transparencës përmes publikimit të të dhënave operationale dhe sigurimit të aksesit jodiskriminues në informacion për përdoruesit e rrjetit, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

9. E DREJTA E INFORMIMIT DHE MBROJTJA E INFORMACIONIT TË NDJESHËM

Në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Programin e Pajtueshmërisë, OSSH sh.a. ka garantuar gjatë vitit 2025 mbrojtjen e informacionit komercialisht të ndjeshëm, si dhe akses jodiskriminues në informacionin me karakter publik.

Zbatimi i këtyre parimeve përbën element thelbësor për ruajtjen e ndarjes funksionale dhe për shmangien e çdo avantazhi konkurrues për subjektet e lidhura brenda shoqërisë vertikalisht të integruar.

▪ Mbrojtja e informacionit komercialisht të ndjeshëm

Në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor dhe Programi i Pajtueshmërisë, OSSH sh.a. ka zbatuar mekanizma organizativë dhe teknikë për mbrojtjen e informacionit komercialisht sensitiv:

- është garantuar ndarja e aksesit në sistemet informatike mbi bazë rolesh dhe autorizimesh
- është zbatuar parimi “need-to-know” për administrimin e të dhënave
- është siguruar që kompanitë motra apo subjektet e lidhura të mos kenë akses preferencial në informacion teknik, tregtar apo financiar
- janë përdorur të dhëna të agreguara dhe të anonimizuara për analiza dhe raportime të përgjithshme.

Nuk janë konstatuar raste të aksesit të paautorizuar apo përdorimit të informacionit në mënyrë që cenon konkurrencën në treg.

▪ Trajtimi konfidencial i informacionit të pjesëmarrësve në treg

OSSH sh.a. ka trajtuar në mënyrë konfidenciale:

- informacionin e ndarë nga furnizuesit, prodhuesit dhe përdoruesit e rrjetit.
- informacionin financiar që ndikon në operimet e pjesëmarrësve në treg.
- informacionin mbi kostot e furnizimit dhe marrëdhëniet kontraktuale.

Informacioni bëhet publik vetëm në rastet kur:

- është klasifikuar si jo-konfidencial nga vetë subjekti.
- kërkohet nga autoritetet kompetente në përputhje me funksionet e tyre ligjore.
- parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

▪ Akses jodiskriminues në informacionin publik

Në zbatim të parimit të barazisë dhe transparencës, OSSH sh.a. ka garantuar akses të njëjtë për të gjithë pjesëmarrësit në treg ndaj informacionit me karakter publik, mbi të njëjtat kushte, procedura dhe standarde cilësie.

Gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë masa për:

- publikimin e rregulloreve dhe procedurave për lidhje në rrjet.

- njoftimin në kohë reale për remontet dhe ndërprerjet e planifikuara.
- funksionimin e platformave digjitale për trajtimin dhe gjurmimin e ankesave.
- forcimin e komunikimit përmes kanaleve zyrtare elektronike.

Këto masa kanë kontribuar në reduktimin e asimetrisë së informacionit dhe në rritjen e gjurmueshmërisë së proceseve.

▪ **Rritja e aksesueshmërisë dhe modernizimi i shërbimeve gjatë vitit 2025**

Në funksion të përmirësimit të shërbimeve dhe në përputhje me standardet bashkëkohore të administrimit publik, gjatë vitit 2025 janë implementuar risi të rëndësishme:

- Rubrika “Raporto Rrezik Elektrik” në www.oshee.al që mundëson raportim të drejtpërdrejtë të situatave të rrezikut elektrik përmes formularit online dhe kodit QR.
- Mundësia e pagesës së faturave me kartë bankare në sportele (nga 1 tetori 2025), me zgjerim progresiv në nivel kombëtar.
- Zgjerimi i shërbimeve online për menaxhimin e kontratave, ankesave dhe kërkesave.
- Mundësia e ndjekjes online të statusit të aplikimeve me kod unik gjurmimi.
- Zhvillimi dhe përdorimi i aplikacionit OSHEE Mobile për akses të shpejtë dhe të sigurt në shërbime.

Këto masa kanë përmirësuar efikasitetin, transparencën, aksesueshmërinë dhe cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve, duke reduktuar ndërhyrjen fizike dhe duke rritur standardet e përgjegjshmërisë institucionale.

▪ **Përputhshmëria me Programin e Pajtueshmërisë**

Në përputhje me Programin e Pajtueshmërisë dhe nenin 72 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, OSSH sh.a. ka garantuar gjatë vitit 2025:

- mbrojtjen e informacionit komercialisht të ndjeshëm nga akses i paautorizuar, veçanërisht nga persona apo struktura të lidhura me aktivitete konkurruese.
- ndalimin e çdo forme përparësie diskriminuese në aksesin ndaj të dhënave teknike, tregtare apo financiare.
- dokumentimin dhe gjurmueshmërinë e procedurave të aksesit, administrimit dhe ruajtjes së informacionit.
- publikimin e njëkohshëm dhe të barabartë të informacionit me karakter publik për të gjithë pjesëmarrësit në treg.

Gjatë vitit 2025 nuk janë evidentuar raste të përfitimit të padrejtë nga shoqëritë e lidhura, as raste të cenimit të konfidencialitetit apo të përdorimit të informacionit në mënyrë që të ndikojë konkurrencën në treg.

Gjithashtu, OSSH sh.a. ka garantuar akses të vazhdueshëm dhe jodiskriminues të përdoruesve në informacion përmes publikimit të numrave të kontaktit rajonal, funksionimit të shërbimit 24/7 për klientët dhe kanaleve zyrtare të komunikimit, duke siguruar trajtim të barabartë dhe transparencë në ofrimin e informacionit.

10. OFRIMI I SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA (SLA)

Në përputhje me Programin e Pajtueshmërisë dhe me nenin 72 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, OSSH sh.a. siguron që çdo shërbim i përbashkët i marrë nga shoqëria vertikalisht e integruar të mos cenojë pavarësinë organizative, funksionale dhe financiare të operatorit të sistemit të shpërndarjes.

Në datë 30.12.2025 është nënshkruar Marrëveshja për Ofrimin e Shërbimeve ndërmjet “OSHEE Group” sh.a., në cilësinë e ofruesit, dhe “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., në cilësinë e përfituesit, me hyrje në fuqi nga 1 janar 2026 dhe me afat 2-vjeçar.

Marrëveshja është hartuar në përputhje me:

- nenin 72 të Ligjit nr. 43/2015.
- Statutin e OSSH sh.a.
- kushtet e licencës së miratuar nga ERE.
- legjislacionin tregtar në fuqi.
- parimet e ndarjes funksionale dhe financiare.

Parimet e ofrimit të shërbimeve të përbashkëta

Në zbatim të Programit të Pajtueshmërisë:

- shërbimet janë të natyrës administrative dhe mbështetëse.
- nuk ndërlidhen drejtpërdrejt me operimin teknik të rrjetit të shpërndarjes.
- nuk ndërhyjnë në vendimmarrjen operationale të OSSH.
- ofrohen mbi bazë të kostos reale.
- nuk krijojnë ndër-subvencionim ndërmjet aktivitetit të rregulluar dhe aktiviteteve konkurruese të grupit.

Shërbimet e përbashkëta përfshijnë:

- Shërbime të Burimeve Njerëzore
(rekrutimi, administrimi i personelit, trajnimet, politikat HR)
- Shërbime Ligjore
(këshillim ligjor, përfaqësim, mbështetje kontraktuale)
- Shërbime Ekonomike dhe Financiare
(planifikim financiar, raportim, kontabilitet, analizë financiare)
- Shërbime të Teknologjisë së Informacionit (IT) dhe Sigurisë Kibernetike
(mirëmbajtje sistemesh, infrastrukturë IT, mbrojtje e të dhënave dhe sistemeve)
- Shërbime të Informacionit dhe Inovacionit
(analiza, zhvillime digjitale, modernizim procesesh)

- Shërbime të Përmirësimit të Performancës (optimizim procesesh, analiza efikasiteti)
- Shërbime Mbështetëse Administrative (logjistikë, administrim i përgjithshëm)
- Shërbime për Projekte me Financim të Huaj (menaxhim projektesh, raportim ndaj institucioneve financuese)

Metodologjia e përlllogaritjes dhe alokimit të kostove

Në përputhje me Programin e Pajtueshmërisë, Marrëveshja specifikon:

- Përshkrimin e detajuar të shërbimit të ofruar.
- Arsyetimin e nevojës për ofrimin e shërbimit nga shoqëria e integruar.
- Kostot totale të ofrimit të shërbimit.
- Metodologjinë e alokimit të kostos.

Kostot llogariten mbi bazë të kostove reale të evidentuara në sistemin financiar SAP dhe planit financiar të miratuar. Faturimi kryhet në baza mujore, me rregullim përfundimtar vjetor sipas kostove faktike.

Metodologjia zbatohet në dy faza:

Faza 1 – Përcaktimi i kostos totale

- Evidentimi i kostove sipas qendrave të kostos në SAP.
- Shpërndarja proporcionale e shpenzimeve të përgjithshme.

Faza 2 – Alokimi ndaj OSSH

Përdorimi i alokatorëve objektivë dhe të matshëm, si:

- numri i punonjësve.
- numri i çështjeve ligjore.
- numri i përdoruesve IT.
- volumet financiare.
- kërkesat për siguri dhe operim.

Alokimi kryhet mbi parimet e:

- transparencës.
- proporcionalitetit.
- gjurmueshmërisë.
- shmangies së ndër-subvencionimit.

Kontrolli i ndër-subvencionimit:

Në përputhje me Programin e Pajtueshmërisë:

- alokatorët janë të identifikueshëm dhe të verifikueshëm
- kostot e alokuara ndaj OSSH nuk përfshijnë shpenzime që lidhen me aktivitete konkurruese;
- nuk transferohen kosto që duhet të përballohen nga shoqëri të tjera të grupit.

Parimet e alokimit dhe zbatimi i tyre janë objekt shqyrtimi nga Zyrtari i Pajtueshmërisë, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë me nenin 72 të Ligjit nr. 43/2015 dhe me kërkesat për ndarje financiare.

Nga monitorimi i kryer gjatë vitit 2025 nuk janë evidentuar raste të ndër-subvencionimit apo alokimit jo-proporcional të kostove.

Përputhshmëria me kuadrin rregullator:

- Sistemi i ofritit dhe alokimit të shërbimeve të përbashkëta garanton.
- ndarje të qartë financiare midis aktivitetit të shpërndarjes dhe aktiviteteve të furnizimit.
- transparencë financiare dhe auditim i pavarur.

Ky organizim është në përputhje me Programin e Pajtueshmërisë dhe garanton që shërbimet e përbashkëta të mos cenojnë konkurrencën në tregun e energjisë elektrike.

11. ZBATIMI DHE DETYRIMI PËR ZBATIM I PROGRAMIT TË PAJTUESHMËRISË

Në përputhje me Programin e Pajtueshmërisë të miratuar nga ERE me Vendimin nr. 257, datë 21.12.2020, si dhe me nenin 72 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, zbatimi i Programit përbën detyrim të detyrueshëm ligjor dhe institucional për:

- drejtuesit e shoqërisë
- punonjësit e të gjitha niveleve
- përfaqësuesit e autorizuar
- audituesit dhe këshilltarët

Programi i Pajtueshmërisë është pjesë integrale e sistemit të qeverisjes së brendshme të shoqërisë dhe mekanizëm konkret për garantimin e ndarjes funksionale, trajtimit jodiskriminues dhe mbrojtjes së konkurrencës në tregun e energjisë elektrike.

■ Informimi dhe konfirmimi i zbatimit

Në funksion të garantimit të zbatimit efektiv të Programit gjatë vitit 2025:

- është realizuar informimi formal i strukturave drejtuese dhe operacionale mbi detyrimet që rrjedhin nga Programi.
- punonjësit kanë konfirmuar me shkrim njohjen dhe angazhimin për zbatimin e tij.

- Programi është komunikuar si detyrim rregullator dhe jo si dokument administrativ i brendshëm.

Zyrtari i Pajtueshmërisë ka vijuar procesin e ndërgjegjësimit institucional, duke theksuar veçanërisht:

- parimin e ndarjes organizative dhe vendimmarrëse.
- ndalimin e çdo forme diskriminimi.
- mbrojtjen e informacionit komercialisht të ndjeshëm.
- detyrimin për raportim të çdo devijimi.

▪ **Trajnimi dhe ndërgjegjësimi**

Në kuadër të forcimit të kulturës së pajtueshmërisë, menjëherë pas marrjes së detyrës, ZP ka zhvilluar trajnim në Rajonin e Tiranës, me pjesëmarrjen e një numri të konsiderueshëm punonjësish, ku janë trajtuar në mënyrë të detajuar:

- përmbajtja e Programit të Pajtueshmërisë.
- detyrimet ligjore që rrjedhin nga neni 72 i Ligjit nr. 43/2015.
- parimet e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë.
- mbrojtja e informacionit komercialisht të ndjeshëm.
- mekanizmat e raportimit pranë Zyrtarit të Pajtueshmërisë.

Gjatë këtyre takimeve është diskutuar hapur me stafin mbi çdo problematikë potenciale dhe është promovuar përdorimi i rubrikës “Raporto / Denonco pranë Zyrtarit të Pajtueshmërisë” si kanal zyrtar dhe konfidencial për raportimin e çdo devijimi.

▪ **Mekanizmi i raportimit dhe trajtimi i shkeljeve**

Në përputhje me Programin e Pajtueshmërisë:

- çdo drejtues apo punonjës ka detyrimin të informojë menjëherë Zyrtarin e Pajtueshmërisë për çdo shkelje apo devijim të mundshëm.
- është në funksion mekanizmi i raportimit përmes rubrikës së dedikuar “Raporto / Denonco pranë Zyrtarit të Pajtueshmërisë”, si dhe përmes kanaleve zyrtare të komunikimit.
- çdo raportim trajtohet në mënyrë konfidenciale dhe verifikohet në përputhje me Programin dhe kuadrin ligjor në fuqi.

Gjatë vitit 2025:

- nuk janë evidentuar raste të refuzimit për zbatim të Programit.
- nuk janë konstatuar raste të mosbashkëpunimit me Zyrtarin e Pajtueshmërisë.
- çdo çështje e ngritur është trajtuar në mënyrë institucionale dhe brenda kompetencave përkatëse.

Në rast konstatimi të shkeljeve, shoqëria ka të drejtë të aplikojë procedura disiplinore në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme.

▪ **Roli dhe pavarësia e Zyrtarit të Pajtueshmërisë**

Në përputhje me nenin 72 të Ligjit nr. 43/2015 dhe Programin e Pajtueshmërisë, gjatë vitit 2025 Zyrtari i Pajtueshmërisës:

- ka monitoruar zbatimin e Programit në strukturat qendrore dhe rajonale;
- ka analizuar dokumentacionin përkatës (vendime, kontrata, rregullore, procedura operative);
- ka propozuar rekomandime për përmirësimin e mekanizmave të kontrollit;
- ka ushtruar funksionin në mënyrë të pavarur dhe të paanshme;
- ka pasur akses të plotë në informacionin e nevojshëm të OSSH dhe të shoqërive të lidhura për përmbushjen e detyrës;
- ka përgatitur dhe paraqitur Raportin Vjetor të Pajtueshmërisë pranë ERE brenda afateve të përcaktuara.

Në funksion të monitorimit efektiv të ndarjes funksionale dhe vendimmarrëse, Zyrtari i Pajtueshmërisës ka marrë pjesë në:

- mbledhjet e strukturave administrative të Drejtorisë Qendrore;
- mbledhjet rajonale me karakter menaxherial dhe operativ;
- mbledhjet e Këshillit të Administrimit të OSSH sh.a., kur janë trajtuar çështje me ndikim në operimin e rrjetit, investimet, alokimin e kostove apo çështje me risk për pajtueshmërinë.

Kjo pjesëmarrje ka mundësuar monitorim të proceseve vendimmarrëse dhe verifikim të respektimit të parimit të ndarjes organizative dhe funksionale.

Zyrtari i Pajtueshmërisës ushtron funksionin e tij në mënyrë të pavarur, pa ndërhyrje nga strukturat menaxheriale apo shoqëritë e lidhura, duke garantuar monitorim objektiv të zbatimit të Programit dhe raportim të drejtpërdrejtë pranë ERE.

12. POLITIKAT DHE PRAKTIKAT E SIGURISË KIBERNETIKE

Politikat dhe praktikat e sigurisë kibernetike gjatë vitit 2025 janë zbatuar në përputhje me:

- Ligjin nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”.
- Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në veçanti nenin 72.
- Rregulloren për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturave Kritike në sektorin e Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin nr. 126, datë 30.07.2020, ndryshuar me Vendimin nr. 79, datë 14.04.2025.
- Urdhrin nr. 97, datë 05.03.2024 mbi dokumentimin dhe implementimin e masave të sigurisë.
- Detyrimin e parashikuar në nenin 10 të rregullores sektoriale për certifikimin sipas standardeve ndërkombëtare të sigurisë së informacionit.

Siguria kibernetike përbën element thelbësor të garantimit të:

- mbrojtjes së informacionit komercialisht të ndjeshëm.
- ndarjes funksionale ndërmjet aktiviteteve të rregulluara dhe atyre konkurruese.
- mosdiskriminimit në aksesin ndaj të dhënave.
- vazhdimësisë së operimit të rrjetit të shpërndarjes si infrastrukturë kritike.

▪ Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit

OSHEE Group sh.a. ka vijuar gjatë vitit 2025 zbatimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI), të ndërtuar në përputhje me standardin ISO/IEC 27001 dhe praktikat NIST.

Në përputhje me nenin 10 të rregullores sektoriale për sigurinë kibernetike, certifikimi sipas ISO/IEC 27001 përbën detyrim ligjor për operatorët e infrastrukturës kritike. Në këtë kuadër, është planifikuar finalizimi i procesit të certifikimit gjatë vitit 2026.

SMSI garanton:

- konfidencialitetin e informacionit.
- integritetin e të dhënave.
- disponueshmërinë e sistemeve kritike.

▪ Zbatimi i detyrimeve sipas Vendimit nr. 126/2020 (i ndryshuar)

Në zbatim të detyrimit për raportim periodik sipas Vendimit nr. 126, datë 30.07.2020, të ndryshuar me Vendimin nr. 79, datë 14.04.2025, masat teknike dhe organizative për vitin 2025 janë dokumentuar dhe përcjellë pranë Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit sipas formatit të kërkuar rregullator.

Gjatë vitit 2025 janë forcuar:

- mekanizmat e monitorimit dhe menaxhimit të incidenteve (SIEM, EDR, UEBA, PAM).
- arkitektura e kontrollit të aksesit mbi bazën e parimit Zero Trust.
- segmentimi i rrjetit dhe mikrosegmentimi për kufizimin e riskut lateral.
- mbrojtja e aplikacioneve online përmes WAF, CWFAP dhe mekanizmave anti-DDoS.
- proceset e menaxhimit të vulnerabiliteteve dhe patch-eve.
- planet e Business Continuity dhe Disaster Recovery.

▪ Auditimet dhe verifikimet e jashtme

Gjatë periudhës 2024–2025 është realizuar vlerësim i infrastrukturës nga struktura ndërkombëtare të sigurisë kibernetike, ku është evidentuar nivel i lartë qëndrueshmërie dhe sigurie.

Në periudhën nëntor 2025 – janar 2026, auditimi i kryer nga Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike (AKSK) ka konstatuar paraprakisht zbatimin e rekomandimeve të përcjella.

13. ROLI I OSSH NË PROCESIN E LIBERALIZIMIT TË TREGUT

Në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, veçanërisht nenet 86 dhe 109, si dhe në përputhje me Programin e Pajtueshmërisë, OSSH sh.a. ka ushtruar rolin e saj si operator i sistemit të shpërndarjes në mënyrë neutrale, transparente dhe jodiskriminuese gjatë procesit të liberalizimit të tregut.

Si operator i rrjetit, OSSH nuk ushtron aktivitet furnizimi dhe ka detyrimin të garantojë akses të barabartë në rrjet për të gjithë furnizuesit e licencuar.

▪ Zhvillimi i procesit të liberalizimit

Procesi i liberalizimit ka nisur në vitin 2018 me daljen në tregun e lirë të konsumatorëve të lidhur në 35 kV. Në vijim, në zbatim të:

- Urdhërrëfimit nr. 28/2021 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
- Urdhrit nr. 217/2023;

Procesi është zgjeruar për konsumatorët e tensionit të mesëm 20/10/6 kV.

Nga 1 janari 2024, konsumatorët e lidhur në 20 kV nuk furnizohen më nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, ndërsa nga 1 janari 2025 procesi është zgjeruar për konsumatorët e lidhur në 10 kV, me rreth 2,500 konsumatorë që furnizohen për herë të parë në një treg të liberalizuar.

- Treguesit e konsumit në tregun e lirë për vitin 2025

Gjatë vitit 2025, rreth 598,298 MWh (9% e konsumit total të shpërndarë) janë furnizuar në tregun e liberalizuar. Nga kjo sasi:

- rreth 7% e konsumit total të shpërndarë është furnizuar nga FTL sh.a.
- pjesa tjetër nga furnizues privatë të licencuar.

Në analizën e konsumit vetëm brenda tregut të lirë:

- 71% është furnizuar nga FTL sh.a.
- 29% nga furnizues të tjerë të licencuar.

Konsumi sipas niveleve të tensionit paraqitet:

UN	FTL	TREG I LIRE	TOTAL
35 KV	33,538,210.55	28,483,662.03	62,021,872.58
20 KV	288,607,557.20	131,766,812.39	420,374,369.59
10 KV	103,487,127.90	12,415,122.47	115,902,250.37
GRAND TOTAL	425,632,896	172,665,597	598,298,493

Në total: 598,298,493 kWh (598,298 MWh).

- Masat për garantimin e neutralitetit dhe mosdiskriminimit

Në funksion të garantimit të procesit të liberalizimit, OSSH sh.a.:

- ka pajisur konsumatorët e tregut të lirë me matës inteligjentë me rezolucion 15-minutësh.
- ka garantuar transmetimin e të dhënave në sistemin AMI/Data Center dhe ndarjen e tyre në mënyrë të barabartë me furnizuesit, OST dhe Operatorin e Tregut.
- ka zbatuar “Rregulloren për Ndryshimin e Furnizuesit” në mënyrë rigoroze, duke respektuar afatet ligjore dhe trajtimin e barabartë të kërkesave.

Gjatë viteve 2024–2025 është zhvilluar dhe vënë në funksion Platforma e Furnizuesit, e cila:

- standardizon procesin e ndryshimit të furnizuesit.
- siguron gjurmueshmëri të plotë të aplikimeve.
- eliminon trajtimin preferencial.
- garanton ndarje të qartë funksionale ndërmjet aktivitetit të shpërndarjes dhe furnizimit.

Në kuadër të Programit të Pajtueshmërisë dhe në përputhje me nenin 72 të Ligjit nr. 43/2015, gjatë vitit 2025:

- është monitoruar trajtimi i kërkesave për ndryshim furnizuesi, bazuar në informacionin dhe të dhënat e vëna në dispozicion nga strukturat përkatëse.
- është verifikuar barazia në aksesin ndaj të dhënave të matjes.
- nuk janë evidentuar raste të diskriminimit apo trajtimit preferencial ndaj furnizuesve të licencuar.

14. PERFORMANCA E RRJETIT DHE MENAXHIMI I HUMBJEVE TË ENERGJISË

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.) është përgjegjës për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe operimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes në të gjithë territorin për të cilin është licencuar, në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

Në kuadër të ushtrimit të këtij funksioni, OSSH sh.a. monitoron dhe menaxhon vazhdimisht performancën e rrjetit të shpërndarjes, përfshirë kontrollin dhe reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike.

Humbjet totale në rrjet përfshijnë:

- humbjet teknike, të lidhura me karakteristikat fizike dhe operimin e rrjetit;
- humbjet joteknike, të lidhura me faktorë administrativë dhe operacionalë.

Gjatë vitit 2025, niveli i humbjeve totale në rrjetin e shpërndarjes rezulton 16.96%, kundrejt objektivit 18.1% të përcaktuar në VKM nr. 758, datë 09.12.2021 “Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik elektroenergjitik”.

Krahasuar me vitin 2024, kur niveli i humbjeve rezultoi 17.93%, viti 2025 paraqet një reduktim prej -0.97%, duke konfirmuar vijimësinë e trendit rënës dhe përmirësimin progresiv të performancës së operatorit në drejtim të reduktimit të humbjeve.

Reduktimi i humbjeve është rezultat i një sërë masash operationale dhe investimeve në rrjetin e shpërndarjes, përfshirë:

- investimet në infrastrukturën e rrjetit dhe modernizimin e teknologjisë;
- përmirësimin e organizimit të punës së strukturave operationale në terren;
- rritjen e efikasitetit të proceseve të monitorimit dhe kontrollit;
- analizën dhe ndjekjen e vazhdueshme të performancës së rrjetit.

Gjatë vitit 2025, energjia e qarkulluar në rrjetin e shpërndarjes është rritur me rreth 4.7%, ose rreth 370.4 GWh më shumë krahasuar me vitin 2024. Pavarësisht rritjes së volumit të energjisë së qarkulluar, niveli i humbjeve në përqindje është ulur me rreth -1.0%, që korrespondon me rreth 13.5 GWh më pak humbje në rrjet krahasuar me vitin paraardhës.

Këto rezultate reflektojnë përmirësim të vazhdueshëm të performancës së operatorit në drejtim të menaxhimit të flukseve energjetike, rritjes së kontrollit operacional dhe optimizimit të përdorimit të infrastrukturës ekzistuese.

Kontributin kryesor në reduktimin e humbjeve e ka dhënë segmenti Tension i Mesëm dhe Tension i Ulët (TM & TU), në të cilin qarkullon pjesa më e madhe e energjisë në rrjetin e shpërndarjes.

Krahasimi i humbjeve sipas niveleve të tensionit paraqitet si më poshtë:

Humbjet ne rrjetin e shperndarjes	Viti 2024	Viti 2025	Reduktimi Humbjeve
TM&TU	16.87%	15.94%	-0.94%
Tension Larte	1.28%	1.23%	-0.05%
Total OSSH. Sh.a	17.93%	16.96%	-0.97%

▪ Tarifat e shpërndarjes së energjisë elektrike

Në zbatim të Vendimit të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 288, datë 23.12.2024, i cili ka lënë në fuqi Vendimin nr. 73, datë 13.04.2022, deri në aplikimin nga OSSH sh.a. për rishikimin e tarifave ekzistuese, tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike kanë mbetur në fuqi për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2025.

Tarifat e miratuara nga ERE sipas nivelit të tensionit janë si më poshtë:

- 1.55 lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV
- 3.99 lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV
- 6.42 lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV

Gjithashtu, është miratuar nga ERE çmimi i aplikueshëm për faturimin e energjisë reaktive, në nivelin 1.92 lekë/kVArh.

Gjatë vitit 2025, OSSH sh.a. ka zbatuar tarifat dhe çmimet e miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë në përputhje të plotë me kuadrin rregullator në fuqi, pa devijime apo aplikim selektiv të tyre ndaj përdoruesve të rrjetit.

▪ Treguesit e Bilancit Energjetik

Në përputhje me kuadrin ligjor dhe modelin e tregut të energjisë elektrike, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes siguron energjinë e nevojshme për furnizimin e konsumatorëve të lidhur në rrjetin e shpërndarjes, përfshirë konsumatorët që furnizohen në kuadër të Shërbimit Universal të Furnizimit.

Energjia elektrike në rrjetin e shpërndarjes injektohet kryesisht nga:

- sistemi i transmetimit (OST)
- impiantet gjeneruese të lidhura në rrjetin e shpërndarjes.

Gjatë vitit 2025, sistemi i transmetimit ka injektuar në rrjetin e shpërndarjes rreth 7,186 GWh energji elektrike, ndërsa impiantet gjeneruese të lidhura në rrjet kanë kontribuar me rreth 1,065 GWh.

Humbjet totale në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2025 rezultojnë në nivelin 16.96%, duke shënuar një përmirësim krahasuar me vitin 2024, çka reflekton vijimin e masave për reduktimin e humbjeve teknike dhe jo-teknike në rrjet.

- **Zbatimi i procedurave të brendshme dhe atyre të miratuara nga autoritetet**

Në zbatim të Procedurës “Për Hartimin e Dokumentacionit Operacional”, Nr. Prot. 1866, datë 29.02.2024, si dhe në përputhje me marrëveshjen për ofrimin e shërbimeve të përbashkëta (SLA) ndërmjet OSHEE Group sh.a. dhe OSSH sh.a., janë hartuar dhe miratuar dokumente operacionale të brendshme (“Udhëzime Pune”) për funksionimin e strukturave përkatëse të shoqërisë.

Këto dokumente kanë për qëllim standardizimin e proceseve të punës, qartësimin e përgjegjësisë funksionale dhe garantimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së shoqërisë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Në këtë kuadër, dokumentacioni operacional është zbatuar nga strukturat përkatëse, përfshirë:

- Sektorin e Bilancit Energjetik dhe Përllogaritjeve;
- Sektorin e Parashikimit dhe Marrëdhënieve me Bursën e Energjisë.

OSSH sh.a. ka zbatuar procedurat dhe udhëzimet e miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), aktet e Këshillit të Ministrave, si dhe aktet e autoriteteve të tjera kompetente, në funksion të garantimit të përputhshmërisë ligjore dhe rregullatore të veprimtarisë së shoqërisë.

15. MONITORIMI I OPERIMIT TË RRJETIT DHE SIGURIA E FURNIZIMIT

Në përputhje me Kodin e Shpërndarjes, Vendimin e Entit Rregullator të Energjisë nr. 181, datë 10.11.2017 “Rregullore për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së siguri së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, si dhe aktet e tjera rregullatore në fuqi, gjatë vitit 2025 është monitoruar operimi i sistemit të shpërndarjes dhe respektimi i standardeve të siguri së furnizimit me energji elektrike.

Struktura organizative e shoqërisë ka garantuar ndarje funksionale ndërmjet:

- Drejtorisë së Operimit
- Drejtorisë së Analizës së Rrjetit, Monitorimit të Kodeve dhe Marrëdhënieve Rregullatore.

Kjo ndarje funksionale kontribuon në menaxhimin e sigurt të operimit të rrjetit dhe në respektimin e kërkesave rregullatore për monitorimin e performancës së sistemit.

▪ **Operimi i sistemit dhe koordinimi institucional:**

Gjatë vitit 2025 është realizuar operimi i sistemit të shpërndarjes në rang kombëtar përmes Dispecerisë Qendrore TL dhe dispecerive rajonale TM/TU, duke siguruar koordinim të vazhdueshëm me Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), veçanërisht në situata që lidhen me:

- stakimet në rrjetin 220 kV.
- aktivizimin e skemave mbrojtëse të sistemit.
- periudhat me prodhim të lartë nga burimet hidroenergjetike.
- menaxhimin e ngarkesave maksimale të sistemit.

Gjithashtu janë zbatuar planet e gatishmërisë për sezonin dimëror dhe veror, si dhe janë respektuar procedurat e rikthimit gradual dhe të sigurt të furnizimit me energji pas avarive në rrjet. Proceset operative janë zhvilluar në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë të përdoruesve të rrjetit, pa evidencë të trajtimit preferencial apo diskriminues.

▪ **Proceset e raportimit dhe marrëdhëniet rregullatore**

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar komunikime institucionale dhe procese raportimi me autoritetet rregullatore dhe operatorët e tjerë të sistemit, përfshirë:

- komunikime dhe takime pune me Entin Rregullator të Energjisë (ERE) për çështje që lidhen me cilësinë e furnizimit dhe operimin e rrjetit.
- koordinime të vazhdueshme me OST sh.a. në lidhje me operimin e sistemeve të ndërlidhura.
- shkëmbim informacioni në kuadër të zbatimit të Kodeve të Rrjetit ndërmjet operatorëve dhe pjesëmarrësve të tregut.
- komunikim institucional me institucione dhe organizata që përfaqësojnë interesat e përdoruesve të rrjetit.

Gjatë periudhës raportuese janë respektuar afatet ligjore për trajtimin e kërkesave dhe për kthimin e përgjigjeve ndaj shkresave zyrtare.

▪ **Monitorimi i treguesve të cilësisë së furnizimit:**

Në zbatim të Rregullores së ERE nr. 181/2017, gjatë vitit 2025 janë monitoruar dhe analizuar treguesit e cilësisë së furnizimit, bazuar në të dhënat e stakimeve në rrjetet TL, TM dhe TU.

Janë realizuar:

- grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave operative.
- llogaritja mujore dhe progresive e treguesve të performances.
- analiza vjetore e treguesve të cilësisë së furnizimit.

Treguesit kryesorë të monitoruar kanë qenë:

- SAIDI (System Average Interruption Duration Index)
- SAIFI (System Average Interruption Frequency Index)
- koha mesatare e riparimit
- energjia e pa furnizuar.

Nga analiza e treguesve rezulton një përmirësim i performancës së sistemit gjatë vitit 2025 në krahasim me vitin 2024, veçanërisht në nivelet e tensionit TL dhe TM, çka reflekton efektin e masave operative dhe të investimeve të realizuara në rrjetin e shpërndarjes.

PERIUDHA Janar- Dhjetor 2025 krahasuar me Vitin 2024						
Emertimi i rrjetit	SAIFI		SAIDI		Ndryshimi ne % SAIDI	Ndryshimi ne % SAIFI
	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2024	Viti 2025		
Total TL	6.29	4.52	11.63	9.11	21.7%	28.1%
Total TM	19.65	16.74	32.05	27.18	15.2%	14.8%
Total TU	1.33	1.37	1.45	1.50	-3.1%	-3.2%
Total OSSH	27.26	22.62	45.13	37.77	16.3%	17.0%

Përmirësimi i treguesve në TL dhe TM dëshmon efektin pozitiv të masave operative dhe investimeve.

Analiza e performancës ka evidentuar nevojën për përqendrim të mëtejshëm të investimeve në TM dhe TU për përmirësim të qëndrueshëm.

▪ **Zhvillimi i sistemeve mbështetëse të operimit**

Gjatë vitit 2025 kanë vijuar proceset për zhvillimin dhe modernizimin e sistemeve mbështetëse të operimit të rrjetit, përfshirë implementimin e sistemit SCADA.

Në këtë kuadër është realizuar:

- Factory Acceptance Test (FAT) në Siemens, Vjenë;
- Site Acceptance Test (SAT);
- instalimi dhe vënia në funksion e sistemit video wall në dispeceri;
- vijimi i implementimit të qendrave lokale SCADA;
- përgatitja e integritit gradual të nënstacioneve në sistem.

Implementimi i këtyre sistemeve pritet të përmirësojë monitorimin në kohë reale të rrjetit, rritjen e kontrollit operacional dhe transparencën në menaxhimin e sistemit të shpërndarjes.

16. ZHVILLIMI I RRJETIT, INVESTIMET DHE MIRËMBAJTJA

Gjatë vitit 2025, OSSH sh.a. ka zhvilluar aktivitetet e mirëmbajtjes parandaluese dhe korrektive, remonteve, riparimit të defekteve dhe ndërhyrjeve në rrjet në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, me qëllim garantimin e operimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes.

Në këtë kuadër, veprimtaria është ushtruar në përputhje me aktet dhe dokumentet rregullatore përkatëse, duke përfshirë ndër të tjera Kodin e Shpërndarjes, rregulloret teknike të zbatueshme, rregulloren për lidhjet e reja, ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore dhe marrëveshjet funksionale të zbatueshme për operimin e rrjetit dhe ofrimin e shërbimit të shpërndarjes.

Në funksion të kësaj veprimtarie janë respektuar parimet e sigurisë teknike, vazhdimësisë së furnizimit, dokumentimit dhe gjurmueshmërisë së ndërhyrjeve, si dhe zbatimit të procedurave të standardizuara sipas përgjegjësisë funksionale të strukturave përkatëse.

▪ Objektivat e ndjekura dhe të realizuara gjatë vitit 2025

Në vijim të planifikimeve teknike dhe prioriteteve operationale, gjatë vitit 2025 OSSH sh.a. ka ndjekur dhe realizuar objektiva të lidhura me:

- rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së furnizimit.
- përmirësimin e qëndrueshmërisë së rrjetit dhe fleksibilitetit të skemave të furnizimit.
- reduktimin e humbjeve teknike dhe joteknike.
- forcimin gradual të rrjeteve 20 kV dhe modernizimin e elementëve kritikë të rrjetit.
- përmirësimin e parametrave të tensionit dhe të saktësisë së matjes.
- rritjen e kontrollit operacional dhe aftësisë monitoruese të sistemit.

▪ Orientimi teknik i investimeve dhe prioriteteve

Investimet gjatë vitit 2025 janë orientuar kryesisht drejt:

- ndërtimit dhe rikonstruksionit të nënstacioneve dhe fuqizimit të kapaciteteve transformuese.
- rikonstruksioneve të rrjeteve TL dhe TM me zëvendësim të pajisjeve të amortizuara.
- kalimit gradual të rrjeteve 6/10 kV në 20 kV.
- investimeve në rrjetin TU me kabëll ABC, me qëllim rritjen e sigurisë, reduktimin e defekteve dhe minimizimin e ndërhyrjeve të paligjshme.
- standardizimit të materialeve dhe forcimit të sistemeve mbështetëse të monitorimit dhe kontrollit.

Këto investime janë realizuar në përputhje me kuadrin rregullator për planifikimin dhe miratimin e planeve të investimeve nga operatorët e sistemit të shpërndarjes dhe transmetimit, si dhe me detyrimet që rrjedhin nga licenca e OSSH sh.a.

▪ Realizimi i investimeve në rrjet gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025 janë realizuar dhe/ose kanë qenë në proces zbatimi investime fizike në rrjet, me fokus përmirësimin e cilësisë së furnizimit, sigurisë së sistemit dhe performancës teknike.

Në këtë kuadër janë realizuar:

- Nënstacione (ndërtim/rikonstruksion): 4 njësi, me fokus rritjen e kapacitetit transformues, zëvendësimin e pajisjeve të amortizuara dhe përmirësimin e skemave të mbrojtjes dhe kontrollit.
- Linja të Tensionit të Lartë (TL): 19.7 km, me ndërhyrje për përforcim rrjeti, zëvendësim përçuesish dhe përmirësim të elementëve mbështetës dhe izolimit.
- Linja të Tensionit të Mesëm (TM).
- ndërtim i ri: 207.6 km.
- rikonstruksion ajror: 1,064.6 km.
- Linja kablllore: 251 km, kryesisht në zona urbane me densitet të lartë.
- Kabina elektrike (të reja/rikonstruksion): 532 njësi.

Këto ndërhyrje kanë kontribuar në reduktimin e defekteve teknike, përmirësimin e parametrave të tensionit, rritjen e fleksibilitetit operativ dhe stabilizimin e furnizimit në segmentet TM/TU.

▪ Plani i Investimeve dhe projektet në vazhdim

Plani i Investimeve për vitin 2025 është miratuar nga organet përkatëse të shoqërisë dhe ka përfshirë zëra prioritarë si nënstacione, linja TL/TM, rrjet TM/TU, kabina elektrike, investime prioritare në zonat me risk teknik, teknologji monitorimi dhe automatizimi, sisteme matjeje dhe kontrolli, pajisje operative, si dhe zëra mbështetës për realizimin e projekteve.

Plani është hartuar mbi bazën e analizave teknike të rrjetit, kërkesave për lidhje të reja, projeksioneve të ngarkesës, standardeve të cilësisë së shërbimit dhe detyrimeve rregullore në fuqi.

Gjatë vitit 2025 janë iniciuar gjithashtu projekte që vijnë në fazë të ndryshme projektimi, tenderimi dhe zbatimi, në funksion të modernizimit të rrjetit, rritjes së qëndrueshmërisë ndaj ngarkesave dhe përmirësimit të aftësisë së sistemit për të integruar konsumatorë dhe burime të reja.

• Komunikimi me ERE për planet e investimeve dhe planin 5-vjeçar të zhvillimit

Në përputhje me kuadrin rregullator për paraqitjen dhe shqyrtimin e planeve të investimeve, gjatë viteve 2024–2025 OSSH sh.a. ka vijuar komunikimin institucional me Entin Rregullator të Energjisë lidhur me:

- planin vjetor të investimeve për vitin 2024.
- planin fillestar të investimeve për vitin 2025.
- përditësimin e planit 5-vjeçar të zhvillimit të rrjetit shpërndarës për periudhën 2023–2027.

Planet dhe informacionet shoqëruese janë depozituar pranë ERE brenda afateve proceduriale, si dhe janë dhënë sqarime dhe plotësime sipas kërkesave të autoritetit rregullator. Në momentin e raportimit, planet e depozituara vijnë të jenë në proces shqyrtimi dhe nuk është dhënë miratim përfundimtar nga ERE.

■ **Investimet në zonat turistike**

Në funksion të përmirësimit të cilësisë së furnizimit dhe përballimit të ngarkesave sezonale, planet e investimeve janë orientuar gjithashtu me fokus të veçantë në zonat turistike, në **zbatim të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për vitin 2025.**

Në këtë kuadër, OSSH sh.a. ka paraqitur pranë ERE informacionin përkatës mbi investimet e planifikuara dhe statusin e realizimit të tyre sipas rajoneve dhe sipas zërave përkatës të investimeve, në funksion të garantimit të transparencës dhe bashkëpunimit institucional me autoritetin rregullator.

■ **Aplikimet për lidhje të reja dhe shtesë fuqie gjatë vitit 2025**

Gjatë vitit 2025 në rrjetin e OSSH sh.a. janë regjistruar gjithsej 20,629 aplikime për lidhje të reja dhe shtesë fuqie, duke reflektuar një kërkesë të lartë për akses në rrjet në nivel kombëtar. Nga këto:

- 13,336 aplikime janë miratuar (rreth 64.6%).
- 1,695 aplikime janë refuzuar (rreth 8.2%).
- 5,598 aplikime janë në proces (rreth 27.1%).

Kjo shpërndarje tregon një nivel të mirë përpunimi të kërkesave dhe një volum të konsiderueshëm aplikimesh në proces, të lidhura kryesisht me faza proceduriale, verifikime teknike dhe plotësim dokumentacioni.

Në aspektin e realizimit, gjatë vitit 2025 janë përpunuar dhe reflektuar në rrjet gjithsej **20,629** lidhje, të shpërndara sipas drejtorive rajonale dhe niveleve të tensionit. Nga pikëpamja rajonale, volumi më i lartë i lidhjeve është regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tiranë, me 6,723 lidhje (rreth 32.6% të totalit), e ndjekur nga Durrësi me 3,479 lidhje (rreth 16.9%) dhe Shkodra me 1,980 lidhje (rreth 9.6%). Këto tre rajone së bashku përbëjnë rreth 59% të totalit të lidhjeve, duke konfirmuar përqendrimin e zhvillimit urban dhe ekonomik në këto zona.

Rajonet e tjera paraqesin një shpërndarje më të balancuar, ku Gjirokastra, Vlora, Elbasani dhe Berati mbajnë një peshë të ndërmjetme, ndërsa Kukësi dhe Burreli paraqesin nivele më të ulëta kërkesë, në përputhje me karakteristikat demografike dhe ekonomike të zonave përkatëse.

Në aspektin teknik, struktura e lidhjeve tregon një dominim të qartë të lidhjeve në tension të ulët:

- 19,811 lidhje në TU (rreth 96%).
- 818 lidhje në TM (rreth 4%).

Ky raport konfirmon se kërkesa për lidhje të reja dominohet nga konsumatorët familjarë dhe bizneset e vogla, ndërsa lidhjet në tension të mesëm mbeten të kufizuara dhe lidhen kryesisht me subjekte me kërkesa më të larta energjie.

Sa i përket aplikimeve të refuzuara, gjatë vitit 2025 janë regjistruar gjithsej 1,666 refuzime, që përfaqësojnë rreth 8.1% të totalit të aplikimeve. Analiza e shkaqeve të refuzimit tregon se:

- 89.7% e rasteve (1,494 aplikime) lidhen me mungesën e dokumentacionit gjatë aplikimit.
- 6.8% (114 aplikime) lidhen me mosrespektimin e afatit për pagesën e preventivit.
- 3.5% (58 aplikime) lidhen me mospërputhje të dokumentacionit teknik me verifikimet në terren apo mosplotësim të kushteve teknike.

Këta tregues evidentojnë se refuzimet burojnë kryesisht nga mosplotësimi i kërkesave procedurale dhe teknike nga ana e aplikantëve dhe jo nga problematika në procesin e trajtimit nga OSSH sh.a., duke reflektuar një zbatim të qëndrueshëm dhe të paanshëm të kriterëve rregullatore.

Në lidhje me trajtimin e ankesave për lidhje të reja, gjatë vitit 2025 janë administruar gjithsej 132 ankesa/kërkesa, të cilat janë trajtuar në përputhje me afatet ligjore. Nga këto:

- 95 ankesa (rreth 72%) janë paraqitur përmes platformës së Bashkëqeverisjes
- 37 ankesa (rreth 28%) përmes Protokollit të OSSH sh.a.

Të gjitha ankesat, pra 100% e tyre, janë trajtuar dhe zgjidhur brenda afateve ligjore, duke dëshmuar eficiencë të lartë në administrimin e kërkesave dhe funksionimin efektiv të mekanizmave të trajtimit të ankesave.

Në tërësi, këta tregues konfirmojnë se gjatë vitit 2025 procesi i lidhjeve të reja dhe shtesave të fuqisë është zhvilluar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, duke garantuar trajtim transparent, jodiskriminues dhe të bazuar në kriterë teknike dhe procedurale të mirëpërcaktuara, si dhe një nivel të lartë përgjegjshmërie në raport me përdoruesit e rrjetit.

▪ **Tarifat e miratuara nga ERE për lidhjet e reja**

Gjatë vitit 2025, OSSH sh.a. ka zbatuar tarifat për lidhjet e reja dhe shtesat e fuqisë në përputhje me Vendimin e Bordit të ERE nr. 145, datë 19.07.2024, “Për miratimin e Rregullores për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”.

Tarifat e aplikuara gjatë periudhës raportuese kanë qenë ato të miratuara nga ERE dhe nuk kanë pësuar ndryshime gjatë vitit 2025. OSSH sh.a. nuk ka aplikuar tarifa jashtë kuadrit të miratuar rregullator dhe ka zbatuar metodologjinë e llogaritjes së kostove sipas rregullores në fuqi.

Për lidhjet në tension të ulët (0.4 kV), tarifimi është zbatuar sipas kategorive të fuqisë së kërkuar dhe preventivët janë hartuar mbi bazën e kostove reale teknike, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga ERE.

▪ **Burimet gjeneruese, vetëprodhuesit dhe kapacitetet e shpërndarjes**

Gjatë vitit 2025, veprimtaria e strukturave përgjegjëse për burimet gjeneruese është përqendruar në integrimin e vetëprodhuesve në rrjetin e OSSH, trajtimin e aplikimeve për lidhje të burimeve të reja gjeneruese dhe miratimin e pikave të lidhjes, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore për akses transparent, jodiskriminues dhe teknikisht të sigurt në rrjet.

Vetëprodhuesit:

Gjatë vitit 2025 janë regjistruar gjithsej 1,261 aplikime për vetëprodhim, me një fuqi totale të kërkuar prej 94,969 kW. Nga këto, janë miratuar 1,184 aplikime, me fuqi totale të instaluar prej 90,737 kW, që përfaqëson rreth 93.9% të numrit të aplikimeve dhe rreth 95.5% të kapacitetit të kërkuar.

Struktura sipas kategorive paraqitet si vijon:

- ✓ privat: përbën kategorinë dominuese me 808 aplikime dhe 88,092 kW fuqi të kërkuar, nga të cilat janë miratuar 763 aplikime me 84,337 kW, duke përfaqësuar rreth 64.1% të numrit të aplikimeve dhe mbi 92% të kapacitetit total të instaluar;
- ✓ familjar: përfaqëson një pjesë të konsiderueshme me 433 aplikime dhe 5,542 kW, nga të cilat janë miratuar 404 aplikime me 5,308 kW, duke zënë rreth 34.3% të aplikimeve, por vetëm rreth 5.9% të kapacitetit total, çka reflekton natyrën e këtyre investimeve me kapacitete të vogla individuale;
- ✓ buxhetor: me 18 aplikime dhe 1,325 kW, nga të cilat janë miratuar 15 aplikime me 1,082 kW, duke përfaqësuar një peshë të kufizuar në totalin e sistemit;
- ✓ jo-buxhetor: me 2 aplikime dhe 10 kW, të cilat janë miratuar plotësisht, me ndikim minimal në strukturën e përgjithshme.

Shpërndarja rajonale vijon të tregojë përqendrim më të lartë në rajonet e Tiranës dhe Durrësit, të cilat përbëjnë pjesën kryesore të numrit të aplikimeve dhe kapaciteteve të instaluar, në përputhje me zhvillimin ekonomik dhe densitetin e konsumit në këto zona.

Integrimi i kësaj kategorie në rrjet është realizuar duke respektuar kriteret e sigurisë dhe stabilitetit të sistemit, si dhe duke monitoruar ndikimin e burimeve gjeneruese, veçanërisht të natyrës fotovoltaike, në bilancin energjetik dhe ngarkesën neto të rrjetit.

Në tërësi, këto të dhëna konfirmojnë një rritje të qëndrueshme të interesit për vetëprodhim, të dominuar nga investimet private dhe në rritje nga segmenti familjar, duke sjellë njëkohësisht nevojën për planifikim të kujdesshëm të kapaciteteve të rrjetit shpërndarës në funksion të garantimit të cilësisë dhe sigurisë së furnizimit.

Opinione paraprake për burime të reja gjeneruese:

Në zbatim të procedurave të parashikuara nga VKM nr. 822/2015, gjatë vitit 2025 OSSH sh.a. ka dhënë 2 opinione paraprake për burime të reja gjeneruese, me fuqi totale të trajtuar 22.4 MW.

Miratime për pika lidhjeje:

Gjatë vitit 2025 janë dhënë 4 miratime për pika lidhjeje për burime të reja gjeneruese, të gjitha për impiante fotovoltaike, me fuqi totale të miratuar 8 MW.

Burime gjeneruese të lidhura në rrjet:

Në vitin 2025 në rrjetin e shpërndarjes janë lidhur gjithsej 16 burime gjeneruese, me fuqi totale 40.93 MW, të shpërndara kryesisht në Fier për impiante fotovoltaike dhe në Elbasan e Berat për hidrocentrale.

Këto zhvillime konfirmojnë rritjen e integrimit të burimeve të rinovueshme në rrjet dhe nevojën për planifikim të kujdesshëm të kapaciteteve të shpërndarjes në funksion të sigurisë dhe cilësisë së furnizimit.

Pikat e karikimit të automjeteve elektrike:

Në kuadër të zhvillimit të mobilitetit elektrik dhe rritjes së numrit të pikave të karikimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, gjatë vitit 2025 është monitoruar zhvillimi i kësaj infrastrukture dhe ndikimi i saj në rrjetin e shpërndarjes.

Sipas kuadrit rregullator në fuqi, duke filluar nga data 1 nëntor 2025, për pikat e karikimit me karakter tregtar me fuqi të instaluar mbi 11 kW, të lidhura në nivelin e tensionit 0.4 kV, aplikohet çmimi prej 22 lekë/kWh.

Ky mekanizëm tarifar synon rregullimin e tregut, ndarjen e qartë ndërmjet karikimit familjar dhe atij tregtar, krijimin e kushteve të barabarta për operatorët dhe reflektimin më të drejtë të kostove reale të furnizimit dhe përdorimit të rrjetit. Gjatë vitit 2025, në rang kombëtar rezultojnë të instaluara:

- 225 pika karikimi
- 20,799 kW fuqi totale e instaluar

Përqendrimi më i madh i pikave të karikimit rezulton në rajonin e Tiranës, e ndjekur nga Durrësi, ndërsa rajone të tjera paraqesin shpërndarje më të kufizuara. Ky zhvillim lidhet me dendësinë më të lartë të automjeteve elektrike, aktivitetin ekonomik dhe zhvillimin e infrastrukturës urbane në këto zona.

17. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË

Kjo pjesë paraqet masat e ndërmarra nga OSSH sh.a. në zbatim të rekomandimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë gjatë periudhës raportuese 2025, me qëllim forcimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe rregullator, garantimin e ndarjes funksionale, përmirësimin e proceseve të brendshme dhe rritjen e transparencës institucionale.

🌟 Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet e mëparshme:

1. Përditësimi i faqes zyrtare të OSSH (www.oss.al):

Është realizuar ridizajnimi dhe përditësimi i faqes zyrtare në bashkëpunim me strukturat përkatëse të OSSH dhe OSHEE Group, me qëllim rritjen e transparencës dhe aksesueshmërisë së informacionit për publikun dhe pjesëmarrësit në treg.

- Publikohen në mënyrë të strukturuar:
- legjislacioni primar dhe sekondar,
- dokumentacioni rregullator,
- njoftime operationale,
- procedurat për lidhje të reja dhe burime të rinovueshme,
- dokumentet institucionale.

Faqja është përshtatur me standardet e sigurisë së sistemeve të informacionit.

Statusi: I zbatuar plotësisht.

2. Publikimi i Programit të Pajtueshmërisë dhe Raportit Vjetor:

Programi i Pajtueshmërisë dhe Raporti Vjetor janë publikuar në gjuhën shqipe dhe angleze në faqen zyrtare, duke garantuar transparencë.

✓ Statusi: I zbatuar plotësisht.

3. Krijimi i rubrikës “Njofto/Raporto te Zyrtari”

Është krijuar dhe funksionalizuar një kanal i dedikuar komunikimi në website për raportim konfidencial të:

- konflikteve të interesit,
- rrjedhjes së informacionit sensitiv,
- trajtimit diskriminues,
- mosrespektimit të Programit të Pajtueshmërisë.

Mekanizmi garanton anonimin dhe trajtimin sipas procedurave të brendshme të Zyrtari të Pajtueshmërisë.

✓ Statusi: I zbatuar plotësisht.

4. Trajnime dhe informime me stafin:

Në kuadër të zbatimit të Programit të Pajtueshmërisë dhe rritjes së ndërgjegjësimit institucional mbi detyrimet që rrjedhin nga kuadri ligjor dhe rregullator në sektorin e energjisë elektrike, gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar takime informuese dhe trajnime me stafin e shoqërisë.

Këto aktivitete kanë pasur si qëllim informimin dhe sensibilizimin e punonjësve mbi parimet dhe detyrimet që burojnë nga Programi i Pajtueshmërisë, në veçanti lidhur me parimin e trajtimit jodiskriminues të përdoruesve të rrjetit, ruajtjen e informacionit të ndjeshëm tregtar, si dhe respektimin e ndarjes funksionale dhe vendimmarrjes së pavarur të operatorit të sistemit të shpërndarjes.

Në këtë kuadër, përveç komunikimeve dhe informimeve të zhvilluara në nivel qendror, janë organizuar gjithashtu aktivitete informuese dhe trajnuese në disa prej strukturave operacionale të shoqërisë, përfshirë një trajnim të zhvilluar në një nga drejtoritë rajonale më të mëdha të OSSH sh.a., ku morën pjesë një numër i konsiderueshëm punonjësish si nga strukturat teknike të terrenit ashtu edhe nga administrata.

Gjatë këtyre sesioneve janë trajtuar çështje që lidhen me zbatimin praktik të Programit të Pajtueshmërisë, përgjegjësitë e strukturave përkatëse, mënyrën e raportimit të rasteve të mundshme të shkeljeve dhe rëndësinë e respektimit të parimeve të transparencës dhe paanshmërisë në marrëdhëniet me përdoruesit e rrjetit.

Dokumentacioni përkatës është shpërndarë pranë stafit dhe janë marrë konfirmime me shkrim mbi njohjen dhe marrjen në dijeni të detyrimeve që rrjedhin nga Programi i Pajtueshmërisë.

✓ Statusi: I zbatuar plotësisht.

5. Miratimi i strukturës së re organizative:

Në zbatim të kërkesave ligjore për ndarje funksionale, Këshilli Mbikëqyrës me Vendimin nr. 32, datë 24.06.2024, ka miratuar strukturën e re organizative të OSSH sh.a.

Struktura garanton:

- ndarje të qartë funksionale,
- transparencë në linjat e raportimit,
- përputhshmëri me parimet e pavarësisë dhe unbundling.

✓ Statusi: I zbatuar plotësisht.

6. Digjitalizimi i shërbimeve dhe monitorimi i avancuar i proceseve:

Në vijim të rekomandimeve të adresuara nga Zyrtari i Pajtueshmërisë në raportin e vitit paraardhës, si dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Draft Rezolutën e Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2024, gjatë vitit 2025 OSSH sh.a. ka ndërmarrë hapa konkretë në drejtim të implementimit të teknologjive të avancuara për monitorimin dhe menaxhimin e proceseve operationale dhe të shërbimeve ndaj konsumatorëve.

➤ Digjitalizimi i trajtimit të ankesave

Në këtë kuadër, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit ka implementuar një platformë digjitale për trajtimin dhe gjurmimin online të ankesave të konsumatorëve, e cila:

- mundëson regjistrimin elektronik të kërkesave dhe ankesave.
- garanton gjurmueshmërinë e plotë të çdo rasti.
- lejon verifikimin në kohë reale të statusit të ankesës nga konsumatori.
- ofron ndërfaqe të aksesueshme si në format web ashtu edhe në aplikacion mobile.
- përmirëson transparencën dhe redukton kohën e përgjigjes.

Kjo platformë përmbush kërkesën për krijimin e një mekanizmi të thjeshtuar dhe të aksesueshëm për konsumatorët, duke forcuar mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe duke rritur përgjegjshmërinë institucionale në trajtimin e ankesave.

➤ Monitorimi në kohë reale dhe menaxhimi i defekteve

Paralelisht, janë ndërmarrë hapa për integrimin e teknologjive të avancuara për monitorimin e rrjetit dhe identifikimin e defekteve në kohë reale, me qëllim:

- identifikimin e menjëhershëm të ndërprerjeve dhe problematikave teknike.
- përshpejtimin e reagimit operacional.

- reduktimin e ndërprerjeve të panevojshme.
- rritjen e qëndrueshmërisë dhe besueshmërisë së rrjetit të shpërndarjes në të gjithë territorin.

Implementimi i këtyre zgjidhjeve teknologjike përbën një hap kyç drejt modernizimit të menaxhimit të rrjetit, përmirësimit të cilësisë së shërbimit dhe konsolidimit të transparencës në marrëdhëniet me konsumatorët dhe furnizuesit.

Vlerësimi i zbatimit:

Nga monitorimi i kryer rezulton se rekomandimi për digjitalizimin e shërbimeve dhe forcimin e monitorimit në kohë reale është zbatuar gjatë vitit 2025, në përputhje me orientimet e Rezolutës së Kuvendit dhe ERE.

Zyrtari i Pajtueshmërisë do të vijojë të monitorojë performancën e këtyre sistemeve dhe efektivitetin e tyre në rritjen e transparencës, trajtimit jodiskriminues dhe përmirësimit të shërbimit ndaj konsumatorëve.

- ✓ Statusi: I zbatuar plotësisht.

7. Finalizimi i Kodit të ri të Shpërndarjes:

Rekomandimi për finalizimin e Kodit të ri të Shpërndarjes nuk është realizuar brenda afatit të deklaruar për vitin 2025, për arsye objektive të lidhura me ndërprerjen e kontratës së asistencës teknike dhe përfundimin e financimit nga programi mbështetës.

Megjithatë:

- është siguruar financim alternativ nga BERZH.
- është lidhur kontrata me konsulentin e ri (2025).
- janë ngritur grupe pune.
- procesi është në vijim me afat përfundimi brenda vitit 2026.

Statusi: Në proces realizimi (me vonesë të arsyetuar nga OSSH/OSHEE).

Vlerësim i përgjithshëm: Nga analiza e mësipërme rezulton se rekomandimet e Zyrtarit të Pajtueshmërisë janë zbatuar në pjesën më të madhe të tyre, me përjashtim të finalizimit të Kodit të ri të Shpërndarjes, i cili aktualisht ndodhet në proces realizimi.

Kjo dëshmon angazhimin institucional të OSSH sh.a. për përmbushjen efektive të detyrimeve ligjore dhe rregullatore, si dhe për forcimin e standardeve të transparencës, ndarjes funksionale dhe pavarësisë së operatorit të sistemit të shpërndarjes.

✦ Rekomandimet e Zyrtarit të Pajtueshmërisë për vitin 2026:

Në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve të brendshme, konsolidimit të ndarjes funksionale dhe garantimit të përputhshmërisë së plotë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, Zyrtari i Pajtueshmërisë adreson rekomandimet e mëposhtme për periudhën 2026:

1. Vijimi dhe përshpejtimi i procesit të Kodit të ri të Shpërndarjes:

Rekomandohet vijimi me prioritet i procesit të hartimit, konsultimit publik dhe paraqitjes për miratim të Kodit të ri të Shpërndarjes, në përputhje me:

- Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;
- kërkesat dhe aktet rregullatore të Entit Rregullator të Energjisë (ERE);
- rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë;
- parimet e transparencës dhe aksesit jodiskriminues në rrjet;
- kërkesat që rrjedhin nga acquis i Bashkimit European në fushën e energjisë elektrike.

Gjatë vitit 2025, në kuadër të ushtrimit të funksionit të monitorimit, Zyrtari i Pajtueshmërisë ka zhvilluar takime dhe komunikime me strukturat dhe drejtuesit përgjegjës brenda shoqërisë, me qëllim nxitjen e progresit dhe konsolidimin e këtij procesi drejt një forme të plotë dhe të zbatueshme të Kodit të ri të Shpërndarjes.

Në këtë kuadër, rekomandohet që shoqëria të intensifikojë përpjekjet për përmbylljen përfundimtare të këtij procesi brenda vitit 2026, në përputhje me angazhimet e saj ligjore dhe rregullatore.

Zyrtari i Pajtueshmërisë do të vijojë të monitorojë në mënyrë periodike progresin e këtij procesi, në funksion të verifikimit të përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe do të raportojë mbi ecurinë e tij deri në finalizimin dhe implementimin e plotë të Kodit të ri të Shpërndarjes, pa ndërhyrë në kompetencat operationale të strukturave përgjegjëse..

2. Përmirësimi i menaxhimit të ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve:

Rekomandohet vijimi dhe forcimi i mekanizmave të monitorimit dhe raportimit për trajtimin në kohë, transparent dhe jodiskriminues të ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe standardet e cilësisë së shërbimit.

Në kuadër të monitorimit të ushtruar gjatë vitit 2025, rezulton se procesi i trajtimit të ankesave dhe kërkesave zbatohet në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara. Megjithatë, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit dhe rritjes së eficiencës operationale, rekomandohet që strukturat përgjegjëse të vlerësojnë dhe, sipas rastit, të zbatojnë masa për:

- vijimin e standardizimit dhe unifikimit të praktikave në të gjitha drejtoritë rajonale, në funksion të garantimit të një trajtimi të njëjtë dhe të qëndrueshëm;
- optimizimin e kohës së trajtimit të ankesave brenda afateve të përcaktuara, me synim rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e përvojës së konsumatorit;

- analizën periodike të ankesave për identifikimin e problematikave të përsëritura dhe risqeve me karakter sistematik, në funksion të parandalimit dhe përmirësimit të proceseve.

Zyrtari i Pajtueshmërisë do të vijojë të monitorojë në mënyrë të pavarur këtë proces, në funksion të verifikimit të respektimit të parimeve të transparencës dhe trajtimit jodiskriminues të përdoruesve të rrjetit, pa ndërhyrë në kompetencat operacionale të strukturave përgjegjëse.

Ky rekomandim synon përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së shërbimit dhe forcimin e besimit të konsumatorëve në operato.

3. Formalizimi i mekanizmave për identifikimin dhe raportimin e konflikteve të interesit:

Rekomandohet vijimi dhe përforcimi i procedurave të brendshme për identifikimin, deklarimin dhe menaxhimin e situatave të konfliktit të interesit, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Në kuadër të monitorimit të ushtruar gjatë vitit 2025, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit që cenojnë ndarjen funksionale apo integritetin e veprimtarisë së shoqërisë. Megjithatë, në funksion të forcimit të mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe parandalimit të risqeve potenciale, rekomandohet që strukturat përgjegjëse të vlerësojnë dhe, sipas rastit, të zbatojnë masa për:

- deklarimin periodik të konflikteve të interesit nga stafi, nëpërmjet formave të standardizuara;
- verifikimin e situatave të mundshme të papajtueshmërisë, përfshirë punësimin paralel apo angazhime të tjera që mund të krijojnë konflikt interesi;
- formalizimin dhe dokumentimin e procedurave për raportimin dhe trajtimin e rasteve pranë Zyrtarit të Pajtueshmërisë, në përputhje me aktet e brendshme në fuqi;
- përdorimin e kanaleve ekzistuese të komunikimit, përfshirë rubrikën e dedikuar në faqen zyrtare të shoqërisë ("Raporto te Zyrtari i Pajtueshmërisë"), si një mekanizëm për raportim konfidencial të situatave të mundshme të konfliktit të interesit.

Çdo raportim i tillë rekomandohet të trajtohet në mënyrë konfidenciale dhe në përputhje me procedurat e brendshme dhe kuadrin ligjor në fuqi.

Zyrtari i Pajtueshmërisë do të vijojë të monitorojë në mënyrë të pavarur këtë proces, në funksion të garantimit të respektimit të parimeve të ndarjes funksionale dhe shmangies së çdo situatë që mund të cenojë paanshmërinë dhe integritetin e veprimtarisë, pa ndërhyrë në kompetencat operacionale të strukturave përgjegjëse.

4. Përforcimi i standardeve të sigurisë së informacionit dhe certifikimi ISO/IEC 27001:

Rekomandohet vijimi dhe përforcimi i masave për garantimin e standardeve të sigurisë së informacionit dhe përmbushjen e kërkesave për certifikimin sipas standardit ndërkombëtar ISO/IEC 27001, në përputhje me nenin 10 të Rregullores së ndryshuar për Sigurinë Kibernetike (Vendimi nr. 79, datë 14.04.2025). Në këtë kuadër, rekomandohet që strukturat përgjegjëse të vijnë dhe, sipas rastit, të intensifikojnë përpjekjet për përafrimin e politikave dhe procedurave të sigurisë së informacionit me kërkesat e këtij standardi, forcimin e mekanizmave të menaxhimit të riskut kibernetik dhe kontrollit të aksesit, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit të stafit mbi mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë e sistemeve informatike.

Zyrtari i Pajtueshmërisë do të vijojë të monitorojë në mënyrë të pavarur progresin e këtij procesi, në funksion të verifikimit të përputhshmërisë me kuadrin rregullator në fuqi, pa ndërhyrë në kompetencat teknike dhe operacionale të strukturave përgjegjëse.

Zbatimi i këtij standardi kontribuon në forcimin e mbrojtjes së sistemeve të informacionit, reduktimin e risqeve kibernetike dhe rritjen e besueshmërisë së infrastrukturës digjitale të shoqërisë.

5. Monitorimi i procesit “Lidhje e Re” dhe indikatorët e performancës

Në funksion të garantimit të aksesit jodiskriminues në rrjet dhe trajtimit të barabartë të të gjithë përdoruesve, rekomandohet forcimi i mekanizmave të monitorimit të procesit “Lidhje e Re”, përmes vendosjes së një qasjeje të strukturuar dhe analitike të monitorimit periodik nga strukturat përgjegjëse të shoqërisë.

Në këtë kuadër, rekomandohet që strukturat përkatëse të vlerësojnë dhe, sipas rastit, të zbatojnë masa për:

- publikimin dhe analizën periodike të indikatorëve të performancës (si afatet e trajtimit, numri i aplikimeve të përfunduara dhe rastet e vonësive), në funksion të rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale.
- analizën sistematike të rasteve të pazgjidhura ose të tejzgjatura në kohë, me qëllim identifikimin e shkaqeve dhe përmirësimin e proceseve.

Zyrtari i Pajtueshmërisë do të vijojë të monitorojë në mënyrë të pavarur këtë proces, në kuadër të verifikimit të respektimit të parimit të mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të përdoruesve të rrjetit, pa ndërhyrë në kompetencat operacionale të strukturave përgjegjëse.

Ky rekomandim synon rritjen e transparencës, gjurmueshmërisë së proceseve dhe minimizimin e riskut për trajtim të pabarabartë të aplikimeve.

18. RAPORTIMI I DETAJUAR NDAJ KËRKESAVE TË ERE

Korrespondenca dhe raportimi me Entin Rregullator të Energjisë (ERE) gjatë vitit 2025 janë realizuar në përputhje me nenet 16 dhe 72, pika 3, gërma "b" të Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenin 11 të Programit të Pajtueshmërisë së OSSH sh.a., miratuar me Vendimin nr. 257, datë 21.12.2020 të Bordit të ERE; si dhe nenin 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me Vendimin nr. 96, datë 17.06.2016.

Në këtë kuadër, Zyrtari i Pajtueshmërisë ka përmbushur detyrimin ligjor për paraqitjen, raportimin dhe ndjekjen e zbatimit të Programit të Pajtueshmërisë, duke garantuar transparencë, komunikim institucional të dokumentuar dhe bashkëpunim të plotë me autoritetin rregullator

Vlerësimi i Raportit Vjetor 2024 nga ERE – Vendimi nr. 187, datë 07.08.2025:

Me Vendimin nr. 187, datë 07.08.2025, Bordi i ERE-s, në ushtrim të funksionit mbikëqyrës mbi pavarësinë funksionale dhe organizative të operatorit të sistemit të shpërndarjes, shqyrtoi dhe vlerësoi Raportin Vjetor të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të OSSH sh.a. për vitin 2024.

Në këtë vendim, ERE konstatoi ndër të tjera:

- ✓ përmbushjen e detyrimit ligjor për dorëzimin e raportit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- ✓ dorëzimin e raportit më datë 26.03.2025, brenda afateve të përcaktuara;
- ✓ përgatitjen e raportit në gjuhën shqipe dhe angleze;
- ✓ publikimin e tij në faqen zyrtare të OSSH sh.a., në përputhje me kërkesat për transparencë publike;
- ✓ zbatimin e një metodologjie të strukturuar kontrolli për mbledhjen dhe analizimin e informacionit;
- ✓ monitorimin e proceseve vendimmarrëse, kontratave, ankesave dhe të dhënave të raportuara nga strukturat e brendshme;
- ✓ ndarjen e qartë funksionale dhe organizative të OSSH sh.a. nga strukturat e integruara vertikalisht;
- ✓ përforcimin e pavarësisë operacionale përmes miratimit të organigramës së re;
- ✓ përmirësimin e transparencës, komunikimit publik dhe shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Në përfundim, Bordi i ERE-s vendosi:

- ✓ miratimin e Raportit Vjetor të Zyrtarit të Pajtueshmërisë për vitin 2024.
- ✓ miratimin e rekomandimeve për vitin 2025.
- ✓ njoftimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, OSSH sh.a., Zyrtarit të Pajtueshmërisë dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Procesi i shqyrtimit dhe korrespondenca zyrtare gjatë vitit 2025:

Në kuadër të shqyrtimit të raportit të pajtueshmërisë dhe komunikimit institucional me ERE gjatë vitit 2025:

- ✓ Më datë 12.05.2025 u zhvillua seanca dëgjimore pranë ERE me Zyrtarin e Pajtueshmërisë.
- ✓ Me shkresën nr. 1426/5 prot., datë 19.06.2025, ERE kërkoi informacion shtesë mbi çështje specifike.
- ✓ Informacioni i kërkuar u përcoll përmes shkresës nr. 3182/2, datë 01.07.2025, brenda afatit të përcaktuar.

Të gjitha komunikimet me ERE janë administruar dhe arkivuar sipas procedurave të brendshme të dokumentimit, duke garantuar gjurmueshmëri të plotë, dokumentim të rregullt dhe akses për verifikim rregullator.

✦ Zbatimi i rekomandimeve të ERE për vitin 2025:

Në funksion të përmirësimit të zbatimit të Programit të Pajtueshmërisë gjatë vitit 2025, dhe në zbatim të rekomandimeve të miratuara me Vendimin nr. 187, datë 07.08.2025 të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), Zyrtari i Pajtueshmërisë ka ushtruar monitorim të dokumentuar dhe ka ndërmarrë masa konkrete për forcimin e kontrollit, strukturimin e raportimit dhe përqendrimin e analizës në dispozitat thelbësore të Programit të Pajtueshmërisë, si më poshtë:

1. Fokusimi në çështjet kyçe të Programit të Pajtueshmërisë

Në përputhje me rekomandimin e ERE, raportimi për vitin 2025 është strukturuar duke u përqendruar drejtpërdrejt në zbatimin e dispozitave themelore të Programit të Pajtueshmërisë, me theks të veçantë në:

- garantimin e ndarjes funksionale dhe organizative të OSSH sh.a.;
- ushtrimin e pavarur të kompetencave operacionale dhe vendimmarrëse;
- trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues të përdoruesve të sistemit të shpërndarjes;
- parandalimin e çdo forme diskriminimi apo favorizimi;
- mbrojtjen dhe administrimin e informacionit komercial sensitiv.

Në këtë kuadër, struktura e raportit për vitin 2025 pasqyron në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimin e dispozitave të Programit të Pajtueshmërisë, duke evidentuar për secilën masë e ndërmarra, mekanizmat e kontrollit të aplikuar dhe nivelin e përputhshmërisë.

Gjithashtu, raporti trajton në mënyrë të strukturuar dhe të integruar të gjitha elementet e Programit të Pajtueshmërisë, të përbëra nga 11 pika kryesore, të cilat rrjedhin nga kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, përfshirë Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe aktet nënligjore të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE).

Monitorimi është realizuar përmes kërkesave zyrtare për informacion drejtuar strukturave përkatëse, analizës së procedurave të brendshme dhe dokumentacionit operacional, verifikimit të, shqyrtimit të

vendimeve të organeve drejtuese, mbledhjeve menaxheriale dhe rajonale, si dhe analizës së ankesave dhe komunikimeve të përdoruesve të sistemit.

2. Monitorimi i procesit të transferimit të punonjësve:

Në zbatim të rekomandimit të ERE, Zyrtari i Pajtueshmërisë ka ushtruar monitorim të dokumentuar dhe të paanshëm mbi procesin e transferimit, emërimit dhe lëvizjes së personelit, me qëllim garantimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe ruajtjen e pavarësisë funksionale të operatorit.

Për vitin 2025, monitorimi është përqendruar në:

- transferimet e brendshme të personelit;
- emërimet në pozicione drejtuese;
- lëvizjet horizontale dhe vertikale në strukturë;
- ndikimin e ndryshimeve organizative në funksionimin e strukturës.

Ky monitorim është realizuar përmes verifikimit të vendimeve formale të strukturave drejtuese, shqyrtimit të dokumentacionit shoqërues, si dhe analizës së përputhshmërisë së procedurave të ndjekura nga Departamenti i Burimeve Njerëzore me kuadrin ligjor në fuqi, përfshirë dispozitat përkatëse të Kodit të Punës dhe rregullat e brendshme të shoqërisë.

Procesi i administrimit të transferimeve dhe lëvizjeve të personelit është ndjekur nga strukturat përgjegjëse të burimeve njerëzore, ndërsa Zyrtari i Pajtueshmërisë ka ushtruar kontroll mbi përputhshmërinë procedurale të tyre, pa ndërhyrë në kompetencat operationale të këtyre strukturave.

3. Ruajtja e pavarësisë dhe integritetit në ushtrimin e funksionit:

Në zbatim të rekomandimit të ERE, Zyrtari i Pajtueshmërisë ka vijuar ushtrimin e funksionit në mënyrë të pavarur, objektive dhe profesionale, në përputhje me kuadrin ligjor dhe Programin e Pajtueshmërisë.

Gjatë vitit 2025, pavarësia funksionale është garantuar përmes:

- raportimit të drejtpërdrejtë pranë ERE-s;
- aksesit të plotë dhe të pakufizuar në informacionin e nevojshëm për ushtrimin e monitorimit;
- pjesëmarrjes në procese monitoruese pa varësi hierarkike nga strukturat operationale.

Në kuadër të ushtrimit të funksionit, Zyrtari i Pajtueshmërisë ka marrë pjesë në takime pune me strukturat drejtuese dhe rajonale të OSSH sh.a., me qëllim ndjekjen e proceseve vendimmarrëse me risk potencial për diskriminim, monitorimin e ecures së aktiviteteve që lidhen me Programin e Pajtueshmërisë dhe forcimin e transparencës në proceset operative. Kjo pjesëmarrje ka pasur karakter monitorues dhe këshillimor, pa ushtruar rol ekzekutiv apo vendimmarrës në proceset teknike dhe tregtare.

Gjatë vitit 2025 është garantuar gjithashtu ruajtja e integritetit profesional, diskrecionit dhe konfidencialitetit të informacionit komercial sensitiv. Nuk janë evidentuar raste ndërhyrjeje, kufizimi apo konflikti i interesit që të cenojnë ushtrimin e pavarur të këtij funksioni.

Në funksion të rritjes së ndërgjegjësimit institucional, ka vijuar funksionalizimi i mekanizmit “Njofto/Raporto tek Zyrtari”, i cili mundëson raportim konfidencial ose anonim të rasteve të mundshme të shkeljeve, me trajtim të dokumentuar dhe në përputhje me procedurat e brendshme.

4. Monitorimi i planit të investimeve dhe zhvillimit të rrjetit:

Në zbatim të rekomandimit të ERE, Zyrtari i Pajtueshmërisë ka përforcuar monitorimin mbi zbatimin e planit të investimeve dhe zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me dokumentet e paraqitura pranë ERE dhe me kuadrin rregullator në fuqi.

Monitorimi është ushtruar në funksion kontrolli, pa ndërhyrë në kompetencat teknike dhe operacionale të strukturave përgjegjëse për planifikimin dhe realizimin e investimeve.

Në këtë kuadër, janë kërkuar të dhëna mbi:

- statusin e projekteve dhe fazën e realizimit.
- progresin fizik të investimeve.
- përputhshmërinë me planin e investimeve.
- respektimin e afateve të deklaruara.
- ndryshimet apo devijimet e mundshme.
- ndikimin e projekteve në kapacitetin dhe sigurinë e rrjetit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë vitit 2025 rezulton se monitorimi është zhvilluar në mënyrë të dokumentuar, duke synuar garantimin që procesi i planifikimit dhe realizimit të investimeve të mos krijojë trajtim preferencial apo diskriminues ndaj përdoruesve të sistemit apo zonave të caktuara të furnizimit. Ky vlerësim bazohet në informacionin e administruar dhe dokumentacionin e shqyrtuar, në kuadër të funksionit monitorues të Zyrtarit të Pajtueshmërisë.

5. Monitorimi i projekteve për matësa dhe matësa inteligjente

Në zbatim të rekomandimit të ERE, gjatë vitit 2025 Zyrtari i Pajtueshmërisë ka forcuar kontrollin dhe raportimin mbi projektet e matjes inteligjente, duke verifikuar statusin e implementimit, nivelin e mbulimit në rrjet dhe përputhshmërinë me strategjinë e zhvillimit të operatorit.

Bazuar në informacionin e verifikuar nga strukturat përgjegjëse të OSSH sh.a. dhe OSHEE Group, rezulton se instalimi i matësve inteligjentë ka vijuar në tensionet 35/20/10/6 kV, si dhe në sistemin e matjes së bilancit në kabinat TM-TU. Gjatë vitit 2025, rreth 71% e energjisë së shpërndarë në rrjetin e tensionit të mesëm është matur përmes sistemeve inteligjente.

Në total, gjatë vitit 2025 janë instaluar 11,814 matësa inteligjente, nga të cilët 7,297 tek konsumatorët dhe 4,517 në sistemin e matjes së bilancit të kabinave, fiderëve dhe tek gjeneruesit e lidhur në rrjet.

Gjithashtu, është monitoruar projekti strategjik “Smart Meters”, i cili zhvillohet si pjesë e programit të modernizimit të OSHEE Group dhe përfshin AMI, MDMS, integrimin me sistemin e faturimit dhe përafrimin gradual me ERP. Gjatë vitit 2025 është përfunduar studimi i fizibilitetit dhe projekti ka hyrë në fazën përgatitore drejt prokurimit.

Rezulton se implementimi i sistemit të matjes inteligjente është në përputhje me objektivat për modernizimin e rrjetit, rritjen e saktësisë së matjes, reduktimin e humbjeve, përmirësimin e faturimit, rritjen e transparencës së të dhënave dhe forcimin e kontrollit operacional të rrjetit.

6. Monitorimi i procedurave të ndërrimit të furnizuesit:

Në zbatim të rekomandimit të ERE, Zyrtari i Pajtuëshmërisë ka përforcuar monitorimin mbi procedurat e ndërrimit të furnizuesit, me qëllim garantimin e zbatimit të drejtë, transparent dhe jodiskriminues të kërkesave të paraqitura nga konsumatorët, në përputhje me rregulloren përkatëse.

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe informacionit të administruar nga strukturat përgjegjëse rezultoi se gjatë vitit 2025 procedurat e ndërrimit të furnizuesit janë zhvilluar brenda afatit maksimal prej 15 ditësh të parashikuar në rregullore. Koha mesatare e trajtimit të aplikimeve ka qenë rreth 5 ditë kalendarike, ndërsa në disa raste të kufizuara procesi ka zgjatur nga 5 deri në 10 ditë, kryesisht për shkak të vonësive në sigurimin e dokumentacionit shoqërues nga furnizuesi aktual.

Deri në përfundimin e fazës testuese të Platformës për Menaxhimin e Furnizuesve, aplikimet janë administruar në mënyrë shkresore ose elektronike, në përputhje me procedurën e përcaktuar në rregullore.

Nga monitorimi i ushtruar gjatë vitit 2025 nuk janë evidentuar ankesa apo elemente që cenojnë parimin e trajtimit të barabartë ose që krijojnë diskriminim në procesin e ndërrimit të furnizuesit..

7. Statusi i finalizimit të Kodit të ri të Shpërndarjes dhe analiza e ndikimit në ndarjen funksionale:

Në zbatim të pikës 7 të seksionit “REKOMANDON” të Vendimit nr. 187, datë 07.08.2025 të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), si dhe në vijim të rekomandimeve të përsëritura të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, të reflektuara edhe në raportimin përkatës të vitit 2025, Zyrtari i Pajtuëshmërisë ka monitoruar ecurinë e procesit për finalizimin e Kodit të ri të Shpërndarjes dhe ndikimin e këtij procesi në përmbushjen e objektivave të ndarjes funksionale të operatorit.

Statusi i procesit të finalizimit:

Afati i deklaruar më parë për përfundimin dhe paraqitjen për miratim të Kodit të ri të Shpërndarjes brenda muajit dhjetor 2025 nuk është realizuar, për arsye objektive të lidhura me ndërprerjen e kontratës së asistencës teknike me konsulentin e mëparshëm Neosadvisory në muajin janar 2025, si pasojë e përfundimit të financimit nga programi mbështetës i USAID.

Pas kësaj situate, janë ndërmarrë masa konkrete për vijimin e procesit, konkretisht:

- është siguruar financim alternativ me grant nga European Bank for Reconstruction and Development (EBRD), në kuadër të Marrëveshjes për Qëndrueshmërinë e OSHEE;
- është përmbyllur procedura e prokurimit ndërkombëtar dhe është përzgjedhur kompania GOPA Tech GmbH si konsulent për hartimin dhe përditësimin e Kodit të ri të Shpërndarjes;
- në periudhën dhjetor 2025 – janar 2026 është zhvilluar takimi zyrtar i nisjes së projektit (“kick-off meeting”), me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të OSSH sh.a., OSHEE Group, EBRD dhe konsulentit;
- afati i parashikuar për realizimin e projektit është 8–9 muaj nga nisja e tij, duke projektuar përfundimin e draftit brenda vitit 2026.

Paralelisht, OSSH sh.a., në bashkëpunim me OSHEE Group, ka ngritur grupe pune ndërdisiplinore me përfshirjen e strukturave teknike, juridike dhe të planifikimit, me qëllim mbështetjen e procesit të rishikimit, harmonizimit dhe përafrimit të Kodit me kuadrin ligjor dhe zhvillimet aktuale të tregut të liberalizuar.

Kuadri ligjor dhe objektivat e rishikimit:

Drafti i ri i Kodit të Shpërndarjes po hartohet në përputhje me:

- acquis të Komunitetit të Energjisë.
- Direktivën 2009/72/EC.
- Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.
- aktet nënligjore dhe rregulloret e miratuara nga ERE.
- zhvillimet e fundit të kuadrit rregullator dhe procesit të liberalizimit të tregut.

Pas përfundimit të draftit, do të ndiqen procedurat e konsultimit publik, seancave dëgjimore dhe paraqitjes për miratim pranë ERE, në përputhje me kërkesat rregullatore në fuqi.

Analiza e ndikimit në ndarjen funksionale:

Kodi i ri i Shpërndarjes vlerësohet si një instrument themelor për konsolidimin e ndarjes funksionale dhe forcimin e pavarësisë operacionale të OSSH sh.a.

Miratimi i tij pritet të kontribuojë drejtpërdrejt në:

- formalizimin dhe standardizimin e procedurave për akses jodiskriminues në rrjet;
- rritjen e transparencës, gjurmueshmërisë dhe parashikueshmërisë në proceset e lidhjes dhe përdorimit të rrjetit;
- përcaktimin më të detajuar të rregullave për trajtimin dhe mbrojtjen e informacionit komercialisht të ndjeshëm;
- harmonizimin e praktikave operacionale në nivel kombëtar;
- reduktimin e riskut të sjelljeve potencialisht diskriminuese ose të paunifikuara në operimin e rrjetit.

Në këtë kuadër, finalizimi i Kodit të ri përbën një masë strukturore me rëndësi të veçantë për përputhshmërinë rregullatore të operatorit dhe për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor kombëtar dhe ai i Komunitetit të Energjisë.

Monitorimi nga Zyrtari i Pajtueshmërisë:

Zyrtari i Pajtueshmërisë do të vijojë monitorimin e këtij procesi deri në finalizimin dhe paraqitjen për miratim të Kodit të ri pranë ERE, duke ndjekur progresin e realizimit, respektimin e afateve të deklaruara dhe çdo element që mund të ndikojë në përmbushjen e objektivave të ndarjes funksionale, trajtimit jodiskriminues dhe përputhshmërisë rregullatore të OSSH sh.a.

8. Monitorimi i Platformës për Menaxhimin e Furnizuesve:

Në zbatim të pikës 8 të seksionit “REKOMANDON” të Vendimit nr. 187, datë 07.08.2025 të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), Zyrtari i Pajtueshmërisë ka ushtruar monitorim mbi procesin

e zhvillimit, funksionalizimit dhe operimit të Platformës për Menaxhimin e Furnizuesve, si një instrument me rëndësi të veçantë për garantimin e transparencës, gjurmueshmërisë dhe trajtimit jodiskriminues në procedurat e ndërrimit të furnizuesit.

Platforma, e cila sipas deklarimeve paraprake parashikohej të bëhej operacionale gjatë muajit korrik 2025, është vënë në operim të plotë më datë 19.11.2025, në adresën elektronike përkatëse.

Verifikimi i funksionalitetit:

Pas vënies në operim, Zyrtari i Pajtueshmërisë ka verifikuar se platforma:

- operon në përputhje me procedurat e përcaktuara në “Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”;
- respekton afatet e parashikuara për administrimin e kërkesave;
- siguron gjurmueshmëri të plotë të aplikimeve dhe transparencë mbi statusin e tyre.

Janë monitoruar gjithashtu rastet e para të përdorimit të platformës nga klientët fundorë, furnizuesi aktual dhe furnizuesi i ri, nga ku rezulton se koha mesatare e trajtimit të procedurave ka qenë rreth 5 ditë, pra brenda afateve të parashikuara në rregullore.

Dokumentacioni shoqërues dhe mekanizmat e kontrollit:

Në kuadër të monitorimit është verifikuar se funksionalizimi i platformës është shoqëruar me:

- dokumentacion të brendshëm rregullator dhe procedura operative.
- manuale përdorimi dhe udhëzime teknike.
- mekanizma kontrolli për administrimin, validimin dhe ndjekjen e kërkesave.
- regjistrim elektronik të veprimeve (log), i cili mundëson gjurmueshmëri të plotë të procesit.

Gjithashtu, është monitoruar funksionimi i mekanizmave të shkëmbimit të të dhënave, njoftimeve automatike, raportimit periodik dhe elementëve të transparencës së platformës, në funksion të sigurimit të një procesi të standardizuar dhe të verifikueshëm për të gjithë pjesëmarrësit.

Nga monitorimi i kryer rezulton se platforma përfaqëson një zhvillim pozitiv në drejtim të standardizimit të procedurave të ndërrimit të furnizuesit, rritjes së transparencës, reduktimit të riskut për trajtim preferencial dhe forcimit të gjurmueshmërisë së procesit.

Funksionalizimi i saj kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në garantimin e trajtimit të barabartë të klientëve, si dhe në forcimin e ndarjes funksionale ndërmjet aktivitetit të shpërndarjes dhe atij të furnizimit.

Vijimi i monitorimit:

Zyrtari i Pajtueshmërisë do të vijojë monitorimin e performancës, transparencës dhe përputhshmërisë së platformës, duke raportuar mbi çdo zhvillim, përmirësim, kufizim operacional apo incident që mund të ndikojë në garantimin e një procesi jodiskriminues, transparent dhe të kontrollueshëm.

9. Monitorimi i përmbushjes së detyrimeve për sigurinë kibernetike:

Në zbatim të pikës 9 të seksionit “REKOMANDON” të Vendimit nr. 187, datë 07.08.2025 të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), si dhe në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga “Rregullorja për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturave Kritike në Sektorin e Energjisë Elektrike”, miratuar me Vendimin nr. 126, datë 30.07.2020, e ndryshuar me Vendimin nr. 79, datë 14.04.2025, Zyrtari i Pajtueshmërisë ka vijuar monitorimin e përmbushjes së kërkesave rregullatore në fushën e sigurisë kibernetike.

Ky monitorim është ushtruar mbi bazë dokumentare dhe përmes verifikimit të informacionit të paraqitur nga strukturat përgjegjëse të OSHEE Group sh.a., nëpërmjet komunikimeve zyrtare, shkëmbimeve elektronike, takimeve të punës dhe mbledhjeve institucionale ndërmjet strukturave përkatëse të OSSH sh.a. dhe OSHEE Group.

Masat e ndërmarra gjatë vitit 2025:

Bazuar në informacionin e administruar dhe të verifikuar, gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë masa të strukturuar për mbrojtjen e infrastrukturave kritike të informacionit dhe për forcimin e kapaciteteve të sigurisë kibernetike, të cilat përfshijnë ndër të tjera:

- menaxhimin e incidenteve dhe monitorimin e vazhdueshëm përmes arkitekturës së integruar SIEM, UEBA, PAM dhe EDR, në mbështetje të procesit të dokumentuar të Incident Response;
- trajnimin dhe ndërgjegjësimin e stafit mbi rreziqet dhe kërcënimet kibernetike;
- kontrollin e aksesit dhe identitetit mbi bazën e arkitekturës Zero Trust dhe auditimeve periodike të aksesit;
- forcimin e sigurisë së rrjetit përmes segmentimit VLAN, implementimit të SD-WAN, DMVPN dhe lidhjeve të sigurta VPN site-to-site;
- sigurinë e aplikacioneve përmes testimeve periodike të vulnerabiliteteve dhe zbatimit të mekanizmave mbrojtës, përfshirë WAF dhe anti-DDoS;
- menaxhimin e vulnerabiliteteve dhe përditësimin e patch-eve për pajisje rrjeti, servera dhe sisteme operative;
- garantimin e vazhdimësisë së shërbimit përmes planeve Disaster Recovery dhe Cyber Recovery;
- auditimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të sigurisë së informacionit.

ISO/IEC 27001 dhe kërkesat e rregullores së ndryshuar:

Në kuadër të ndryshimeve të miratuara me Vendimin nr. 79, datë 14.04.2025, dhe në përputhje me nenin 10 të rregullores së ndryshuar, i cili parashikon pajisjen me certifikim ISO/IEC 27001 brenda afatit 18-mujor nga hyrja në fuqi e ndryshimeve, është monitoruar progresi drejt përmbushjes së këtij detyrimi.

Nga informacioni i verifikuar rezulton se strukturat përgjegjëse kanë nisur procesin e përafrimit me kërkesat e standardit ISO/IEC 27001, duke përgatitur dokumentacionin përkatës, vlerësimin e boshllëqeve dhe planin e veprimit për certifikim gjatë vitit 2026.

Vijimi i monitorimit:

Zyrtari i Pajtuëshmërisë do të vijojë monitorimin e përmbushjes së këtyre detyrimeve, me fokus të veçantë në:

- zbatimin e plotë të kërkesave të rregullores së ndryshuar;
- progresin e procesit të certifikimit ISO/IEC 27001;
- dokumentimin dhe verifikueshmërinë e masave të ndërmarra;
- ndikimin e tyre në mbrojtjen e informacionit komercialisht të ndjeshëm dhe në ruajtjen e integritetit të proceseve kritike të operatorit.

10. Raportimi mbi burimet vetëprodhuese dhe gjeneruese:

Në përmbushje të rekomandimit të Bordit të ERE, Zyrtari i Pajtuëshmërisë ka përfshirë në raportimin vjetor 2025 informacion mbi burimet vetëprodhuese dhe gjeneruese të lidhura në rrjetin e shpërndarjes, me fokus në fuqinë e instaluar, shpërndarjen sipas rajoneve, zhvillimet kryesore gjatë vitit raportues dhe ndikimin e tyre në operimin dhe ngarkesën neto të rrjetit.

Ky raportim është hartuar në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Ligjin nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, VKM nr. 822/2015, Udhëzimin nr. 3, datë 20.06.2019, si dhe kuadrin teknik e rregullator në fuqi për lidhjen dhe operimin e këtyre burimeve në sistemin e shpërndarjes.

Konsumatorët Vetëprodhues (Prosumatorët):

Gjatë vitit 2025 është konstatuar një rritje e qëndrueshme e numrit të konsumatorëve që aplikojnë për lidhje në rrjet në cilësinë e vetëprodhuesit të energjisë elektrike, kryesisht nga burime fotovoltaike, në përputhje me nenin 15 të Ligjit nr. 7/2017.

Gjatë këtij viti janë regjistruar gjithsej 1,261 aplikime për vetëprodhim, me një fuqi totale të kërkuar prej 94,969 kW. Nga këto, janë miratuar 1,184 aplikime, me një fuqi totale të instaluar prej 90,737 kW, që përfaqëson rreth 93.9% të numrit të aplikimeve dhe rreth 95.5% të kapacitetit të kërkuar.

Struktura sipas kategorive paraqitet si vijon:

- ✓ Privat: 808 aplikime me fuqi të kërkuar 88,092 kW, nga të cilat janë miratuar 763 aplikime me 84,337 kW, duke përfaqësuar rreth 64.1% të numrit të aplikimeve dhe mbi 92% të kapacitetit total të instaluar;
- ✓ Familjar: 433 aplikime me fuqi 5,542 kW, nga të cilat janë miratuar 404 aplikime me 5,308 kW, duke zënë rreth 34.3% të aplikimeve, por vetëm rreth 5.9% të kapacitetit total, çka reflekton natyrën e investimeve me kapacitete të vogla individuale;
- ✓ Buxhetor: 18 aplikime me fuqi 1,325 kW, nga të cilat janë miratuar 15 aplikime me 1,082 kW, me peshë të kufizuar në totalin e sistemit;
- ✓ Jo-buxhetor: 2 aplikime me fuqi 10 kW, të miratuara plotësisht, me ndikim minimal në strukturën e përgjithshme.

Shpërndarja rajonale vijon të tregojë përqendrim më të lartë në rajonet e Tiranës dhe Durrësit, të cilat përbëjnë pjesën dominuese të numrit të aplikimeve dhe kapaciteteve të instaluar, në përputhje me

zhvillimin ekonomik dhe densitetin e konsumit në këto zona. Rajone të tjera si Elbasani, Shkodra dhe Berati paraqesin gjithashtu një rritje të qëndrueshme të interesit për vetëprodhim.

Integrimi i kësaj kategorie prodhuesish në rrjet është realizuar duke respektuar kriteret e sigurisë dhe stabilitetit të sistemit, si dhe duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme ndikimin e burimeve gjeneruese, veçanërisht të natyrës fotovoltaike, në bilancin energjetik dhe ngarkesën neto të rrjetit.

Në këtë kuadër, zhvillimi i vetëprodhimit ka kontribuar në:

- uljen e konsumit neto nga rrjeti gjatë orëve me prodhim maksimal;
- rritjen e flukseve të kundërta të energjisë në segmente të caktuara të rrjetit;
- rritjen e nevojës për monitorim të avancuar të tensionit dhe balancës së ngarkesës.

Dhënia e opinioneve paraprake për burime të reja gjeneruese:

Në zbatim të VKM nr. 822/2015, gjatë vitit 2025 OSSH sh.a. ka trajtuar kërkesat për opinione paraprake për burime të reja gjeneruese, si pjesë e procedurës për vlerësimin paraprak të mundësisë së lidhjes në rrjetin e shpërndarjes.

Gjatë periudhës raportuese janë dhënë 2 opinione paraprake, me një fuqi totale të trajtuar prej 22.4 MW.

Këto opinione përbëjnë fazën fillestare të procedurës dhe konfirmojnë përputhshmërinë teknike paraprake të projekteve me kërkesat e rrjetit.

Miratimet e pikës së lidhjes për burime gjeneruese:

Gjatë vitit 2025 janë dhënë 4 miratime për pika lidhjeje për burime të reja gjeneruese, të gjitha për impiante fotovoltaike, me një fuqi totale të miratuar prej 8 MW.

Ky zhvillim reflekton rritjen e interesit për integrimin e burimeve të rinovueshme dhe kërkon vlerësim të vazhdueshëm të ndikimit në rrjet, në aspektin e tensionit, kapaciteteve transformuese dhe sigurisë së operimit.

Burimet gjeneruese të lidhura në rrjet gjatë vitit 2025:

Gjatë vitit 2025 janë lidhur në rrjetin e shpërndarjes gjithsej 16 burime gjeneruese, me një fuqi totale prej 40.93 MW.

Shpërndarja sipas rajoneve dhe teknologjisë paraqitet si vijon:

- Fier: impiante fotovoltaike – 12 burime / 24 MW;
- Elbasan: hidrocentrale – 2 burime / 2.73 MW;
- Berat: hidrocentrale – 2 burime / 14.2 MW.

Vlerësimi i përgjithshëm:

Nga monitorimi rezulton se integrimi i burimeve vetëprodhuese dhe gjeneruese në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit 2025 është zhvilluar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe mbi bazën e kriterëve teknike objektive dhe jodiskriminuese.

Rritja e numrit të vetëprodhuesve dhe e kapaciteteve të reja gjeneruese ka shtuar nevojën për monitorim më të avancuar teknik dhe për vlerësim të vazhdueshëm të ndikimit të tyre në ngarkesën neto të rrjetit, bilancin energjetik, parametrat e tensionit dhe kapacitetin pritës të sistemit.

Në këtë kontekst, OSSH sh.a. vijon të zhvillojë mekanizmat e monitorimit dhe analizës teknike, me qëllim garantimin e integritetit të sigurt, efektiv dhe jodiskriminues të këtyre burimeve në sistemin e shpërndarjes.

19. KONKLUZIONE

Raporti Vjetor i Pajtueshmërisë për vitin 2025 paraqet në mënyrë të strukturuar vlerësimin mbi zbatimin e Programit të Pajtueshmërisë në OSSH sh.a., në përputhje me nenin 72 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, aktet nënligjore përkatëse dhe vendimet e Entit Rregullator të Energjisë (ERE).

Ky raport është hartuar mbi bazën e informacionit, dokumentacionit dhe të dhënave të depozituara pranë Zyrtarit të Pajtueshmërisë nga departamentet dhe strukturat përkatëse të OSSH sh.a., si dhe nga strukturat përgjegjëse të OSHEE Group sh.a., në funksion të ushtrimit të monitorimit të zbatimit të Programit të Pajtueshmërisë.

Nga analiza e kryer rezulton se gjatë vitit 2025 OSSH sh.a. ka ushtruar aktivitetin e saj në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, duke respektuar parimet e pavarësisë funksionale, transparencës, trajtimit jodiskriminues të përdoruesve të rrjetit dhe mbrojtjes së informacionit komercialisht të ndjeshëm. Gjatë periudhës raportuese nuk janë evidentuar shkelje të natyrës thelbësore që të cenojnë këto parime.

Në vijim të progresit të arritur në vitet e mëparshme, gjatë vitit 2025 është konsoliduar më tej zbatimi i parimeve të ndarjes funksionale të operatorit të sistemit të shpërndarjes, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor kombëtar dhe detyrimet që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë.

Zyrtari i Pajtueshmërisë vlerëson pozitivisht bashkëpunimin me strukturat e OSSH sh.a., OSHEE Group sh.a., dhe Entin Rregullator të Energjisë (ERE), bashkëpunim i cili ka kontribuar në garantimin e një procesi transparent dhe të dokumentuar të monitorimit dhe zbatimit të Programit të Pajtueshmërisë gjatë vitit 2025.

Në funksion të forcimit të mëtejshëm të transparencës dhe garantimit të trajtimit jodiskriminues, inkurajohen të gjithë përdoruesit e rrjetit që, në rast se konstatojnë apo dyshojnë për trajtim të pabarabartë, kufizim të të drejtave apo çdo devijim nga kuadri rregullator, të adresojnë shqetësimet e tyre përmes kanaleve zyrtare të komunikimit të OSSH dhe OSHEE sh.a., përfshirë rubrikën “Raporto/Denonco pranë Zyrtarit të Pajtueshmërisë” dhe kontaktet e vëna në dispozicion nga shoqëria. Çdo sinjalizim trajtohet në mënyrë konfidenciale, të paanshme dhe brenda afateve të arsyeshme, me qëllim garantimin e një zgjidhjeje të drejtë dhe efektive.

OSSH sh.a. mbetet e angazhuar për përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të saj të operimit dhe për forcimin e mëtejshëm të kulturës së pajtueshmërisë, në përputhje me zhvillimet e acquis të Bashkimit European dhe kërkesat e Komunitetit të Energjisë.

Ervis Hazizi

Zyrtari i Pajtueshmërisë, OSSH Sh.a.

Tiranë, Mars 2026

